



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

DREJTIMI PENAL

TEMA E MAGJISTRATURËS

TË DREJTAT E FËMIJËVE NË KOSOVË

MENTORI:

Prof. Dr. Ismail Zejneli

KANDIDATJA:

Nora Maloku

Tetovë, 2018



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

DREJTIMI PENAL

TEMA E MAGJISTRATURËS

TË DREJTAT E FËMIJËVE NË KOSOVË

MENTORI:

Prof. Dr. Ismail Zejneli

KANDIDATJA:

Nora Maloku

Tetovë, 2018

PËRMBAJTJA

HYRJE	1
ARSYESHMËRIA E PUNIMIT	3
METODOLOGJIA E PUNIMIT.....	4

Kapitulli I

1.1 Zhvillimi historik i të drejtave të fëmijëve	5
1.2 Kronologjia e të drejtave të fëmijëve.....	8
1.3 Mbrojtja ligjore e të Drejtave të Fëmijëve sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.....	11
1.4 Mbrojtja ligjore e të Drejtave të Fëmijëve sipas Ligjit të Punës, Kodit Penal të Kosovës dhe Ligjit Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare në Kosovë.....	13
1.5 Mbrojtja ligjore e të Drejtave të Fëmijëve sipas Kartës Sociale Europiane (e rishikuar).....	17

Kapitulli II

2.1 Dhuna nëpër shkolla në Kosovë	19
2.2 Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës.....	27
2.3 Konventa Europiane për të Drejtat e Fëmijëve “Për Marrëdhëniet me Fëmijët” dhe “Mbi ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve”	30
2.4 Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve.....	32
2.5 Organizatat për të Drejtat e Fëmijëve që veprojnë në Kosovë (UNICEF, Save the Children, etj.)	34

Kapitulli III

3.1 Analiza statistikore të institucioneve relevante mbi të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë	39
3.2 Të Drejtat e Fëmijëve të prekur nga sindromi Down në Kosovë	45
3.3 Iniciativat e OJQ-ve të tjera mbi mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë	48

Kapitulli IV

4.1 Avokati i Popullit si mbrojtës i të Drejtave të Fëmijëve	49
4.2 Shkeljet e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë	53

KONKLUSIONI	57
--------------------------	----

BIBLIOGRAFIA	59
---------------------------	----

Hyrje

“Në qoftë se dëshirojmë të krijojmë një paqe të qëndrueshme, duhet të fillojmë nga fëmijët”

MAHATMA GANDI

Tema e hulumtimit tim, “Të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë”, trajton dhe analizon gjendjen e të drejtave të fëmijëve në vendin tonë, mbrojtjen dhe promovimin e tyre, pavarësisht se a janë në konflikt apo në kontakt me ligjin, si dhe garantimin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të tyre të proklamuar edhe në instrumenteve ndërkombëtare si dhe në ligjet e aplikueshme vendore dhe rajonale për mbrojtjen e këtyre drejtave.

Të drejtat e fëmijëve, është një temë aktuale, sa e rëndësishme, aq edhe e ndjeshme dhe vazhdon të jetë e përfolur dhe e debatuar. Pothuajse çdo ditë është në fokus të gazetave e mediave.

Tema e hulumtimit tim, është elaboruar duke e ndarë në kapituj dhe nënkapituj. Pjesa e parë fillon me trajtimin e historikut kronologjik të rregullimit juridik të të drejtave të fëmijëve, jep definimin e fëmijës me zhvillimin gradual të aftësive dhe vazhdon me instrumentet ndërkombëtare dhe vendore të cilat përcaktojnë dhe garantojnë promovimin e të drejtave të fëmijëve. Ky studim ka për qëllim vlerësimin e strukturës së tanishme legjislativë në Kosovë dhe përmbushjes së saj me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes dhe drejtësisë për fëmijë.

Në kapitullin e dytë të këtij punimi kam trajtuar mbrojtjen ligjore të fëmijëve, të adresuar nga organizatat ndërkombëtare, si dhe organizatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që veprojnë në Kosovë si dhe rregullimin e tyre me anë të instrumenteve ndërkombëtare.

Kapitulli i tretë i punimit i kushtohet kategorisë së veçantë të të drejtave të fëmijëve, me theks të veçantë atyre që janë të prekur me sindromën down si dhe iniciativat e OJQ-ve mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Si dhe në kapitullin e fundit të këtij punimi do të flas për Institucionin e Avokatit të Popullit si mbrojtës i të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjithësi e në veçanti mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut në Kosovë.

Tema përfundon me konkluzionet e arritura gjatë studimit të temës.

Përmes këtij punimi synojë të jap një kontribut modest për opinionit e gjerë që të kuptojë më mirë rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

ARSYTUESHMËRIA E PUNIMIT

Sot, në vende të ndryshme të botës, përfshirë këtu edhe vendin tonë, fatkeqësisht njohim shumë shkelje të të drejtave të fëmijëve, sidomos në vende të varfëra, ku fëmijëve u imponohet kryerja e punëve të rënda, mandje fëmijët përdoren si fuqi punëtore.

Arsyeja pse e kam zgjedhur këtë temë qëndron në faktin se fëmijët meritojnë mbrojtje, gëzim të drejtash që u takojnë, sepse në Kosovë cënimi i të drejtave të tyre vazhdon të mbetet evident.

Secili fëmijë ka të drejtat e tij të cilat edhe i ka të garantuara t'i shfrytëzojë. Por, prindërit, mësuesit, shoqëria civile, për shkaqe të ndryshme, qofshin rrethanat ekonomike dhe shumë faktorë të ndryshëm shpiejnë në mosrespektimin mandje edhe në shkeljen e tyre. Disa fëmijë i gëzojnë e disa të tjerë nuk i gëzojnë. Me fjalë tjera, ka raste kur bota është e padrejtë me ta.

Një arsye tjetër që më ka bërë të përcaktohem për këtë temë është edhe dëshira e madhe që të gjithë fëmijët të mund të kënaqen duke i jetësuar të drejtat e tyre në praktikë dhe në jetën e përditshme të tyre. Roli dhe rëndësia e tyre është e paimagjinueshme në jetën tonë. Ata mund të na duken të vegjël, por pikërisht janë ata të cilët mund të ndryshojnë të ardhmen. E ardhmja e kombit nuk varet vetëm nga të rriturit, por nga fëmijët, të cilët vijnë nga një mjedis i shëndoshë, aty janë respektuar të drejtat më esencile të tyre, sikurse janë: e drejta në jetë, e drejta për identitet dhe nënshtetësi, e drejta në shëndet, në arsim, barazia dhe mosdiskriminimi, qasja në drejtësi, etj.

Këto të drejta të sipërpërmendura, janë të përcaktuara në instrumente vendore dhe ndërkombëtare për të siguruar aplikimin e tyre dhe u japin mbrojtje të drejtave të fëmijëve.

Këshillimi i tyre është mëse i nevojshëm në mënyrë që ti mbajmë ata larg duarive negative, sepse dhuna apo dukuritë tjera nuk kanë dobi efekt pozitiv tek zhvillimi emocional i tyre.

Shoqëria si tërësi, duhet t'i mbrojë fëmijët nga diskriminimi, sepse vetëm në këto forma, duke i respektuar të drejtat e tyre mund të rregullojmë të ardhmen, sepse asgjë materiale nuk vlen sa fëmijët, lumturia dhe harmonia e tyre, e posaçërisht rritja dhe edukimi në një ambient të shëndoshë e cila padyshim se do reflektohet në zhvillimin mendor dhe emocional të secilit fëmijë.

METODOLOGJIA E PUNIMIT

Metodologjia hulumtuese, e cila përdoret në këtë studim është analiza kualitative dhe kuantitative.

Disa nga metodat që do të përdoren gjatë këtij punimi janë:

*** Metoda historike:**

Me anë të kësaj metode do të përpiqen të sqarojnë evoluimin historik të rregullimit instrumental ligjor të të drejtave të fëmijëve.

*** Metoda deskriptive:**

Përmes kësaj metode do të bëhet përshkrimi i nocionit të fëmijës, elaborimi i të drejtave të fëmijëve, duke u bazuar nga të dhënat e literaturës së përdorur në këtë punim, si dhe rregullimi juridik i të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

*** Metoda krahasuese:**

Kjo metodë nënkupton krahasimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në instrumente të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si dhe në rajone tjera.

*** Metoda kuantitative dhe kualitative:**

Lidhur me këto metoda kemi hartuar një pyetësor rreth dhunës në shkolla, ku janë anketuar gjithsejt 80 nxënës të moshës 12-15 vjeç në dy shkolla fillore të Komunës së Prizrenit. Rezultatet e anketës janë përpunuar dhe janë prezantuar në mënyrë statistikore në punim.

Kapitulli I

1.1 Zhvillimi historik i të drejtave të fëmijëve

Të drejtat e njeriut, u takojnë njësoj edhe të gjithë fëmijëve pa dallim.

Shprehjet “të drejtat e njeriut”, “të drejtat njerëzore”, “të drejtat e personit” janë përdorur në mënyre alternative për t’iu referuar të njëjtit koncept. Më përpara përdorshin më shpesh shprehjet “të drejta natyrore” dhe “të drejta origjinare”. Gjithashtu, edhe shprehja “të drejta morale”, e përdorur nga Stuart Mill, bën pjesë në filozofinë juridike të këtyre të drejtave. Më vonë, pasi të drejtat e njeriut filluan të inkorporoheshin brenda deklaratave të para kombëtare dhe ndërkombëtare apo dhe në kartat kushtetuese kombëtare, u fillua të flitej dhe për “të drejta themelore” apo “liri themelore”. Duke analizuar terminologjinë e përdorur nga shekulli XVIII deri më sot – të drejtat e njeriut – arrihet në përfundimin se koncepti “njeri” i referohet qenies njerëzore në mënyrën më të gjërë të mundshme, edhe pse duhet nënvizuar që hera herës termi është përdorur për t’iu referuar vetëm disa kategorive të qenieve njerëzore (shtetasve, grave, fëmijëve, punëtorëve, të huajve, refugjatëve etj).¹

Të drejta e njeriut kanë kaluar në disa faza. Faza e parë është ajo e rrënjëve filozofike të të drejtave të njeriut, faza e të drejtës universale. Ideja e barazisë së të gjithë njerëzve (e drejta natyrore), e cila vlen për të gjithë, është zhvilluar qysh në filozofinë antike greke, pra para më shumë se 2000 vjetësh. Në krishtërimin e hershëm dhe në fetë e tjera, kjo traditë e të drejtave të njeriut është zhvilluar më tej. Megjithatë, në atë kohë, ato nuk kishin të bënin shumë me realitetin politik. Ato pasqyronin më shumë mendime filozofike, të cilat edhe pse në fakt kishin ngritur kërkesa universale, zbatimin praktik në jetën politike e përjetuan hap pas hapi në fillim të Epokës së Re.²

Faza e dytë është ajo e zbatimit politik, në kuadrin e shteteve kombëtare. Në këtë fazë shohim hartimin e një sërë “dokumenteve të rëndësishëm ligjor” në kuadrin e të drejtave të njeriut si përsëmbull: “Magna Carta Libertatum”, apo “Petition of rights”. Një

¹ Ervis Martani, *Origjina dhe Evoluimi i të Drejtave të Njeriut*, <http://myschool.al/resources/Historia-e-te-drejtave-te-njeriut.pdf>, (qasur më: 05.10.2018)

² Xhulia Karaj, *Bazat filozofike të të drejtave të njeriut*, Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Europiane, Profili: Legjislacioni dhe Institucionet Europiane, 2015, f. 2-3

tjetër dokument i rëndësishëm është “Habeas Corpus”, e cila shënoi kalimin vendimtar në fazën e shpalljes së idesë së të drejtave të njeriut si të drejta të shprehura me ligj, në të drejtën konkrete të shtetit. Viti 1776 prodhoi dokumentat më të rëndësishme në lidhje me të drejtat e njeriut: “Bill of rights” dhe “Deklarata Universale e të Drejtave të njeriut”. Bill of rights cilësoi si të drejta të patjetërsueshme dhe thelbësore një sër të drejtash si e drejta për jetë, liri dhe pasuri; lirinë e mbledhjes dhe lirinë e shtypit; e drejta e peticionit; e drejta për mbrojtje juridike si dhe e drejta e votës.³

Përpjekjet për zbatim universal politik dhe juridik të të drejtave të njeriut, përbëjnë fazën e tretë të zhvillimit të të drejtave të njeriut.⁴

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta personale, që kanë të bëjnë me të drejtën e jetës e cila mbrohet me ligj dhe njeh parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Pas Luftës së Parë Botërore, një nga aktet e para të rëndësishme të Lidhjes së Kombeve të krijuar ishte miratimi i Deklaratës së Gjenevës, e cila në pesë pika përcakton të drejtat e fëmijëve dhe përgjegjësitë e të rriturve për respektimin e këtyre të drejtave. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve është një traktat ndërkombëtar i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 20 nëntor 1989. Disa nga parimet bazë janë: mosdiskriminimi, interesi më i lartë i fëmijës, pjesëmarrja e fëmijëve në vendimet që ndikojnë tek ata, e drejta për mbijetesë dhe zhvillim.⁵

Interesi më i lartë i fëmijëve është edukimi cilësor, zhvillimi i personalitetit individual të fëmijëve, i prirjeve dhe aftësive të tyre, duke marrë në konsideratë karakteristikat, interesat dhe nevojat e të nxëniet të tyre.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve përfaqëson një grupim normash dhe detyrimesh, që kanë për qëllim të pranohen në mbarë botën të cilat mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Komuniteti ndërkombëtar, përmes këtij teksti, bëri të njohur se qeniet njerëzore nën 18 vjeç duhet dhe kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë. Më 19 dhjetor 2011 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Protokollin e tretë Fakultativ të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, duke krijuar një procedurë individuale të ankimit, në rastet e shkeljeve të të

³ Xhulia Karaj, *Bazat filozofike të të drejtave të njeriut*, Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Europiane, Profili: Legjislacioni dhe Institucionet Europiane, 2015, f. 2-3

⁴ Ibidem

⁵ Avokati i Popullit, *Historiku*, <http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/historiku-1>, (qasur më: 05.10.2018)

drejtave të fëmijëve. Protokolli i tretë opcional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve ka hyrë në fuqi në prill 2014.⁶

Në mes të tjerash, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, në preambullën e saj përcakton se familja, si njësi bazë e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi; Duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi; Duke pasur parasysh se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e idealeve të shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sidomos në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit; Duke mbajtur parasysh se, ashtu siç është thënë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës “fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të p osaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes”, Duke pranuar se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t’u kushtohet një vëmendje e veçantë, Duke mbajtur parasysh si duhet rëndësinë e traditave dhe të vlerave kulturore të çdo populli në mbrojtjen dhe zhvillimin e harmonishëm të fëmijës, Duke pranuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve në të gjitha vendet, dhe veçanërisht në vendet në zhvillim.⁷

Konventa shpreh atë që është parë si një qëndrim i ri nga ana e bashkësisë ndërkombëtare ndaj fëmijëve të botës dhe gjendjes së tyre, një qëndrim që është përshkruar si duke parë fëmijët në kuptimin jo të dashurisë, por të të drejtave të qenësishme.⁸

Shtetet që janë palë në konventë janë të detyruar të zhvillojnë dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet dhe politikat nën dritën e interesave më të mira të fëmijës.

Pra, Shtetet palë janë dakorduar për promovimin dhe garantimin e të gjitha të drejtave të cilat përshkruhen shprehimisht edhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

⁶ Ibidem

⁷ Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

⁸ A. Glenn Mower, Jr., *The Convention on the Rights of the Child*. (Westport, Connecticut, London: Greenwood Press, 1997), p. 5

Njëherit, Konventa në fjalë është instrumenti më i pranuar, në nivel botëror, i të drejtave të njeriut në histori.

1.2 Kronologjia e të drejtave të fëmijëve

Termi “të drejtat e fëmijëve” është një koncept që ka ndryshuar, në kuptim të evoluimit gjatë gjithë historisë njerëzore. Nëse shikohet në mënyrë kronologjike, njerëzimi nuk ka “luftuar” prej fillimit për të gjitha të drejtat që sot ekzistojnë dhe i gëzojmë. Pra, lufta për të drejtat e njeriut në përgjithësi, e për të drejtat e fëmijëve në veçanti, fillon me përpjekjet për t’u njohur të drejtat e njeriut, fillon me përpjekjet për t’u njohur të drejtat më themelore (elementare) të tilla si: e drejta për jetën dhe e drejta për të qenë i lirë.

Shekulli XX që nga dekadat e para, karakterizohet me nisma e angazhime të rëndësishme në fushën e të drejtave të fëmijës. Bartës të këtyre nismave janë njerëz të vullnetit të mirë, të mobilizuar individualisht dhe në organizata të ndryshme. Këto angazhime kanë rezultuar me një varg dokumentesh që fuqizuan të drejtat e fëmijëve në botë.⁹

Disa nga këto janë:

- Deklarata e të Drejtave të Fëmijës, e njohur edhe si Deklarata e Gjenevës e të Drejtave të Fëmijës, është një dokument ndërkombëtar që promovon të drejtat e fëmijës, i shkruar nga Eglantyne Jebb dhe i miratuar nga Lidhja e Kombeve më 1924.¹⁰
- Në frymën e parimeve që kishte përcaktuar Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1959 shpalli Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës.

Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në nenin 25 par. 2, në mënyrë shprehimore thotë: “Nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale”,

⁹ Krenare Lleshi dhe Veton Sylhasi, *Fëmijët tanë Udhëzues praktik për prindër dhe mësime dhënë*, (Prishtinë: Qendra për Arsimin e Kosovës, 2017), f. 15

¹⁰ Ibidem

kurse në nenin 26 par. 3, thotë: “Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në rradhë të parë prindërit”.¹¹

E drejta e fëmijëve për shkollim parakupton përgjegjësinë e fëmijëve për:

1. vijimin e rregullt të mësimi;
2. respektimin e mësimdhënësve dhe të personelit tjetër të shkollës;
3. respektimin e shokëve të klasës;
4. respektimin e rregullave të shkollës;
5. kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe
6. përvetësimi e programit shkollor.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj) është një deklaratë e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948 në Palais de Chaillot, Paris. Deklarata lindi si përgjigje ndaj tmerreve të Luftës së Dytë Botërore dhe përfaqëson përpjekjen e parë globale për të artikuluar mbrojtjen e atyre të drejtave që shumë njerëz besonin se ishin të drejta themelore që i takojnë të gjitha qenieve njerëzore.

Neni 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. “Të gjitha të drejtat e njeriut për të gjithë” ishte parulla e Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, të vitit 1993. Të drejtat e njeriut, janë ato që u japin fuqi individëve dhe bashkësive të kërkojnë transformimin e plotë të shoqërisë në drejtim të realizimit të plotë të të gjitha të drejtave të njeriut. Konfliktet duhet të zgjidhen me mjete paqësore, duke u bazuar në sundimin e ligjit dhe në strukturën e të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, të drejtat e njeriut mund të ngatërrohen mes vete; ato kufizohen nga të drejtat dhe liritë e të tjerëve ose nga kërkesat morale, publike, ose të rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme të një shoqërie deomokratike (Neni 29). Të drejtat e të tjerëve, jo vetëm që duhet të tolerohen, por edhe duhet të respektohen. Të drejtat e njeriut nuk mund të përdoren për shkeljen e të drejtave njerëzore të të tjerëve (Neni 30); kështu që, edhe pse në disa situata të jashtëzakonshme dhe raste ekstreme, mund të vihen disa kufizime, të gjitha konfliktet duhet të zgjidhen në frymën e të drejtave të njeriut. Prandaj, çdokush - gratë, burrat, të rinjtë dhe fëmijët duhet t’i dijnë dhe kuptojnë të drejtat e tyre njerëzore, që janë të rëndësishme për interesat dhe qëllimet e tyre. Kjo mund të arrihet përmes arsimit dhe mësimi për të drejtat e njeriut, arsimim ky

¹¹ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Neni 25 dhe Neni 26, 1948

që mund të jetë zyrtar, jozyrtar ose joformal. Kuptimi i parimeve dhe procedurave të të drejtave të njeriut, ua mundëson njerëzve të marrin pjesë në vendimet që përcaktojnë jetën e tyre, të punojnë drejt zgjidhjes së konflikteve dhe ruajtjes së paqes të bazuar në të drejtat e njeriut, e cila është një strategji frytdhënëse e bazuar në interesat e popullit për zhvillim njerëzor, social dhe ekonomik.¹²

- Më 1979, gjatë vitit ndërkombëtar të fëmijës, u bë një propozim për të zgjeruar këtë deklaratë dhe për ta bërë të obligueshme nën ligjin ndërkombëtar. Në rrjedhën e këtyre përpjekjeve u prezantua drafti i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës i shkruar nga qeveria e Polonisë.¹³
- Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijës, u miratua nga KB më 20 nëntor 1989 dhe hyri në fuqi më 2 shtator 1990.¹⁴

Neni 1 i KDF cek se:

Për qëllimet e kësaj Konvente, me *fëmijë* nënkuptohet çdo qenie njerëzore nën Moshën (18) tetëmbëdhjetë vjet, përveç nëse sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijë mosha madhore arrihet më herët.¹⁵

Konventa për Parandalimin e Torturës (CPT) ka përcaktuar disa garanci specifike për mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimet në burgje. Kjo konventë ka ligjëruar qëndrimin e mbajtur në disa juridiksione sipas të cilit pozicioni delikat i të miturve kërkon që të merren masa mbrojtëse shtesë.¹⁶

Sipas Konventës së lartëcekur, fëmijët, në të gjitha rrethanat të jetë ndër të parët për të marrë mbrojtje dhe ndihmë. Fëmija do të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e lënies pas dore, mizorisë dhe shfrytëzimit, poashtu, fëmijët nuk do të jenë objekt i trafikimit. Edhe pse mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është një nga qëllimet kryesore të shoqërisë, përsëri ato përballen me probleme të shumta. Ndër problemet me të cilat përballen shoqëria sot në të drejtat e fëmijëve janë: trafikimi dhe përdorimi i fëmijëve për prostitucion;

¹² Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948, <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>, (qasur më: 12.09.2018)

¹³ Krenare Lleshi dhe Veton Sylhasi, *Fëmijët tanë Udhëzues praktik për prindër dhe mësime dhënëse*, (Prishtinë: Qendra për Arsimin e Kosovës, 2017), f. 15

¹⁴ Ibidem

¹⁵ Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

¹⁶ Fondacioni SLYNN, *Zbatimi i të Drejtave të Njeriut në Praktikë*, Londër, UK, 2016, f. 190

mosfrekuentimi dhe braktisja e shkollës për arsye të ndryshme, shfrytëzimi i fëmijëve në sektorin e punës, keqtrajtimi i fëmijëve me precedente penale, etj., mosrespektimi i të drejtave të tyre për edukimin e barabartë etj. Një ndër problemet më kryesore e më të vështira është trafikimi i fëmijëve në mbarë botën për qëllime të ndryshme përfitimi.

1.3 Mbrojtja ligjore e të drejtave të fëmijëve sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Kushtetura është akti më i lartë juridik dhe politik i një shteti me të cilën duhet të jenë në harmoni të gjitha ligjet tjera vendore.

Kushtetuta e Kosovës e njeh Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës dhe korniza ligjore e Kosovës bazohet në standarde të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale që reflekton një zotim për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të të rinjëve.

Të Drejtat e Fëmijës janë përcaktuar në nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sikurse mëposhtë:¹⁷

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.
2. Fëmijët e lindur jashtë martesë, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë.
3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.
4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.
5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008

Bazuar në dispozitat e nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shohim se nga aspekti ligjor, këto të drejta si, mbrojtja e fëmijëve, kujdesi për mirëqenien e tyre, barazia mes fëmijëve martesore dhe atyre të lindur jashtë martese, mbrojtja nga dhuna, keqtrajtimi, interesi më i mirë i fëmijës, garantohen përmes aktit më të lartë juridik.

Në një shoqëri sikur Kosova, ku fëmijët dhe të rinjtë përbëjnë 60 përqind të popullatës është e rëndësishë kruciale të investohet në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, pa marrë parasysh a janë ata në konflikt apo në kontakt me ligjin. Investimi në fëmijë dhe të rinjë nënkupton poashtu investim në të ardhme. Fëmijët që janë subjekt i sistemit të drejtësisë për ndonjë arsye duhet të kenë qasje dhe shërbime të duhura të kujdesit. Ky parim, bazuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, është universal dhe bën pjesë në Kushtetutën e Kosovës nëpërmjet të cilës kjo është bërë drejtpërdrejtë e aplikueshme.¹⁸

Në mesin e shumë instrumenteve ndërkombëtare, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në dispozitat e saj ka inkorporuar edhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, ku kjo Konventë gjen zbatim direkt.¹⁹

Kushtetuta e Kosovës njih disa të drejta të fëmijëve, dhe përfshin Konventën për të Drejtat e Fëmijëve në rendin ligjor shtetëror. Kjo është pozitive, por nuk do të ishte realiste të pritet që të gjitha të drejtat e fëmijëve të njihen shprehimisht me Kushtetutë. Për më tepër, legjislacioni i zakonshëm ndonjëherë kufizon shkallën në të cilën fëmijët kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat kushtetuese. Kushtetuta e Kosovës e njih lirinë e asociimit në terma të gjerë e të përgjithshëm, por legjislacioni rregullon ushtrimin e kësaj të drejte vetëm nga personat mbi moshën 15 vjeçare. Kjo nënvizon nevojën për të siguruar që legjislacioni i zakonshëm të njih dhe rregullojë të gjitha të drejtat e fëmijëve.²⁰

Në Kosovë pjesa legislative e kornizës ligjore është e mirë, por është e vështirë që të njihen të gjitha të drejtat e fëmijëve me amendamentimin e legjislacionit të zakonshëm.

¹⁸ Dan O'Donnell, *Korniza Ligjore mbi të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë, Studim mbi pajtueshmërinë e legjislacionit në fuqi me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve*, Unicef: Prishtinë, 2014, f. 5

¹⁹ Kushteuta e Republikës së Kosovës, Neni 22, 2008

²⁰ Dan O'Donnell, *Korniza Ligjore mbi të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë, Studim mbi pajtueshmërinë e legjislacionit në fuqi me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve*, Unicef: Prishtinë, 2014, f. 14

Vlen të ceket se, me rastin e hartimit, Kushtetuta e vendit tondë, ka marrë për bazë modelet e Kushtetutave bashkëkohore të vendeve të ndryshme, me qëllim që ajo të përfshijë të drejtat dhe detyrimet më esenciale lidhur me të drejtat e fëmijëve.

1.4 Mbrojtja ligjore e të Drejtave të Fëmijëve sipas Ligjit të Punës, Kodit Penal të Kosovës dhe Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare në Kosovë

Ligji i Punës (Nr. 03/L-212), që ka hyrë në fuqi në 16 dhjetor 2010, është pjesë e legjislacionit bazë të Republikës së Kosovës që rregullon marrëdhënien midis punëmarrësve dhe punëdhënësve. Ky ligj ka për qëllim të mbrojë të drejtat e të caktojë detyrimet në marrëdhëniet e punës, dhe të sigurojë mbrojtjen në punë. Dispozitat e tij zbatohen si për punësimin në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

Ligji i punës nuk përmban një përkufizim të fëmijës, por asnjë përkufizim nuk është i nevojshëm pasi që dispozitat e kodit që kanë të bëjnë me fëmijën nuk i përfshijnë të gjithë fëmijët, por vetëm fëmijët e grupmoshave të veçanta që janë të identifikuar nga nenet në fjalë.²¹

Ligji i punës lejon punësimin e fëmijëve të moshës 15 deri 18 vjeç në “punë të lehta që nuk përfaqësojnë rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre”, me kusht që kjo punë nuk është e ndaluar nga ndonjë ligj apo normë tjetër juridike.²²

Në veçanti, ai ndalon punësimin e personave të moshës nën 18 vjeç në punë nëntokësore apo nënujore, punë në lokale të mbyllura, punë në lartësi të rrezikshme, punën që përfshin makineri ose mjete të rrezikshme, transportin e objekteve apo materialeve të rënda, dhe të punojnë në një mjedis jo të shëndetshëm që ekspozon punëtorët ndaj substancave apo proceseve të rrezikshme, apo temperaturave, niveleve të zhurmës ose vibracioneve që mund të jenë të dëmshme për shëndetin.²³

²¹ Dan O'Donnell, *Korniza Ligjore mbi të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë, Studim mbi pajtueshmërinë e legjislacionit në fuqi me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve*, Unicef: Prishtinë, 2014, f. 26

²² Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, 2010, Neni 7.2

²³ Po aty, Neni 45.5

Nga punëdhënësit gjithashtu kërkohet që të vlerësojnë rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve nën moshën 18 vjeçare dhe të ndërmarrin masat e duhura për t'i mbrojtur ata kundër këtyre rreziqeve.²⁴

Ligji i Punës në Kosovë përmban disa nene që njohin të drejtën e fëmijëve 15 deri 18 vjeç dhe që janë të punësuar nën kushte të punës që janë më të favorshme se ato të të rriturve. Fëmijët 15 deri 18 vjeç që janë të punësuar nuk mund të punojnë më shumë se 30 orë në javë, dhe nga ata nuk mund kërkohet të punojnë “jashtë orarit”.²⁵

Ata kanë të drejtë për një pushim prej 30 minuta pas punës prej 4 orë e gjysmë, dhe për një pushim javor prej të paktën 36 orë.²⁶

Puna e natës është e ndaluar, dhe të punësuarit nën moshën 18 vjeç nuk mund të transferohen në një tjetër vend pune pa pëlqimin e tyre.²⁷

Ligji i Punës përmbush shumicën e standardeve relevante ndërkombëtare dhe në disa fusha shkon më tej se që kërkojnë standardet ndërkombëtare.

Përveç Ligjit të Punës, edhe Kodi Penal i Kosovës garanton mbrojtjen ligjore të të drejtave të fëmijëve.

Sipas këtij Kodi, Fëmijë, konsiderohet person i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet.²⁸

Kodi penal i Kosovës e parasheh si krim kur një zyrtar publik shpall / zyrtarizon një martesë duke e ditur se ekziston një pengesë ligjore. Detyrimi i një fëmije që të martohet gjithashtu është krim, i cili dënohet me burgim nga 2 deri në 10 vjet, ose më gjatë nëse fëmija është nën moshën 16 vjeçare dhe autori i krimit është prindi ose vepra është kryer për përfitime financiare. Të jetuarit në një marrëdhënie jashtëmartesore me një fëmijë tëmoshës nën 16 vjet gjithashtu është krim, i cili dënohet me burgim deri në 20 vjet.²⁹

Kodi penal gjithashtu njeh torturën si krim, që dënohet me burgim prej 1 deri në 15 vjet. Dënimi minimal është 3 vjet kur viktima është fëmijë.³⁰ Keqtrajtimi nga një zyrtar

²⁴ Po aty, Neni 45. 2-3

²⁵ Po aty, Neni 20.3, Neni 23.5 dhe Neni 45. 5.4

²⁶ Po aty, Neni 28.3, Neni 31.2

²⁷ Po aty, Neni 27.1, Neni 27.3

²⁸ Kuvendi i Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2012, Neni 120.20

²⁹ Po aty, Neni 245, 246, 247

³⁰ Po aty, Neni 199.1, 199.2

publik gjithashtu është krim, që dënohet me burgim deri në 3 vjet, apo nga 6 muaj deri në 5 vjet nëse viktima është fëmijë.

Kodi Penal i Kosovës parashikon vepër penale që qendrat tregtare të shërbejnë alkool për personat nën moshën 16 vjeçare. Kjo është një përgjigje pozitive për këtë rekomandim të projektuar për të mbrojtur të drejtën e fëmijëve për shëndet.

Kodi Penal i Kosovës ndalon shitjen, blerjen, importimin, prodhimin, kultivimin, transportimin, shpërndarjen, posedimin dhe administrimin e materieve narkotike dhe psikotrope, si dhe financimin, menaxhimin dhe organizimin e aktiviteteve të tilla.³¹

Kodi Penal gjithashtu njeh tre krime të tjera seksuale që në mënyrë specifike kanë të bëjnë me fëmijët. Neni 237 e konsideron si krim shitjen, shfaqjen ose ofrimin e pornografisë një fëmijë nën moshën 16 vjeçare, dhe neni 240 e konsideron krim nxitjen e një personi 16 ose 17 vjeç që të kryejë akte seksuale duke i premtuar martesë në mënyrë të rrejshme. Neni 236 e konsideron krim “ndërmjetësimin”, sigurimin, krijimin e mundësisë, joshjen, nxitjen ose detyrimin e një fëmijë nën moshën 16 vjeç që të përfshihet në akte të paligjshme seksuale me një palë të tretë. Dënimi për këtë krim varion nga nën 5 vjet deri 3 deri në 15 vjet, në varësi të moshës së fëmijës, rolit të kryerësit dhe aktit të lehtësuar ose inkurajuar.³²

Përveç këtyre, Kodi Penal njeh edhe një numër të konsiderueshëm të veprave që kanë të bëjnë me fëmijët viktime si dhe parasheh sanksione në raste të tilla.

Kodi Penal, kështu përmbush plotësisht standardet ndërkombëtare, për sa i përket obligimit për të kriminalizuar trafikimin e fëmijëve.

Lidhur me mbrojtjen ligjore të të drejtave të fëmijëve, vlen të përmendet edhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Në vitin 2012, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare është ndryshuar me shtimin e një neni për fëmijët nën 14 vjeç të përfshirë në veprimtari të paligjshme, dhe një neni tjetër për fëmijët e përfshirë në sjellje “anti-sociale”.

Sipas dispozitave të këtij Ligji, në të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme.³³

³¹ Po, aty, Neni 273-279

³² Po aty, Neni 237 dhe Neni 26

³³ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, 2007, Neni 9

Ligji në fjalë fokusohet në mbrojtjen e interesave të fëmijëve.

Interesat më të mira të fëmijës zakonisht përmbushen kur nevojat e zhvillimit të tyre fizik dhe psikologjik plotësohen brenda kontekstit të familjes natyrore të tij. Prandaj Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale dhe ata që veprojnë në emër të saj duhet të bëjnë çdo përpjekje të promovojnë mirëqenien e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike përmes ofrimit të përkujdesjes dhe këshillimit social dhe, në raste të jashtëzakonshme, asistencës materiale. Vetëm në rrethanat kur ka arsye për të dyshuar se një fëmijë është duke pësuar dëm serioz në shëndetin e tij fizik ose mendor, ose është në rrezik për diçka të tillë brenda familjes së tij, mund të merret në konsideratë heqja e tij nga përkujdesja e prindit ose prindërve ose përkujdesësit tjetër të tij. Kur dyshohet në abuzimin e ndonjë fëmije, organet për zbatimin e ligjit kanë për detyrë që t'i ndihmojnë qendrës për punë sociale në vlerësimin e saj gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës për shërbime sociale dhe familjare dhe të zhvillojë hetimet e veta kriminale nëse rrethanat e arsyetojnë këtë.³⁴

Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Përveç në rrethana të jashtëzakonshme të nevojës dhe të mbrojtjes, këto shërbime do t'u ofrohen personave në nevojë dhe familjeve në suaza të komunitetit e jo nëpër institucione rezidenciale.³⁵

Ky Ligj, për të mos hyrë në përshkrimin e detajuar, ka ka për qëllim rregullimin dhe përparimin shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë, për familjet dhe fëmijët në veçanti.

Dispozitat e këtij Ligji për mbrojtjen e familjes dhe fëmijëve janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare të kërkuara nga bashkësia evropiane. Përkundër kësaj, në vendin tonë, mbetet ende shumë punë për të bërë, në kuptim të garantimit të mbrojtjes së

³⁴ Po aty, Neni 10.1, 10.2, 10.10

³⁵ Po aty, Neni 1.1

këtyre të drejtave në praktikë, ngase vërehet qartë se ekziston një diskrepancë mes teorisë dhe zbatimit të tyre në praktikë.

Një numër i madh i fëmijëve të globit janë viktimë të keqtrajtimit. Fëmijët jetojnë në familje ku ata janë të ekspozuar ndaj dhunës, abuzohen seksualisht dhe madje vriten. Megjithë, në angazhimin pothuajse global për sigurimin e të drejtave të fëmijës, shumica e fëmijëve të botës, nuk kanë mbrojtje adekuate nga dhuna. Për sa kohë që kjo vazhdon, mund të presim që fëmijët të rriten me sjellje të dhunshme, agresive dhe kriminale.³⁶

Një e drejtë e njeriut asnjëherë nuk do të respektohet nëse një individ apo autoritet nuk merr përgjegjësinë për realizimin e saj. Edhe pse qeveritë janë bartësit kryesor të detyrimeve në këtë rast, ka shumë nevojë që organet tjera dhe individët të promovojnë dhe të mbrojnë të drejtat njeriut. Çdo individ ka përgjegjësi morale t'i kontribuojë një kulture në të cilën vlerat e të drejtave të njeriut shkaktojnë sjelljen tonë në jetën e përditshme.³⁷

Zbatimi dhe respektimi i këtyre të drejtave mundëson zhvillimin normal, të natyrshëm dhe të plotë të fëmijës.

1.5 Mbrojtja ligjore e të Drejtave të Fëmijëve sipas Kartës Sociale Europiane (e rishikuar)

Ligji vendor ose ndërkombëtar mund të deklarojë se fëmijët kanë të drejta të veçanta, të drejtat që nuk i posedojnë të rriturit dhe që u akordohen fëmijëve në bazë të statusit të tyre si fëmijë.³⁸

Karta Sociale Europiane (e rishikuar), është një dokument i vendve anëtare të Këshillit të Europës që i kushton një rëndësi të veçantë mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore.

³⁶ Katherine Covell and R. Brian Howe, *Children, Families And Violence Challenges For Children's Rights*. (London and Philadelphia: Jessica Kingsley Publishers, 2009), p. 11

³⁷ Living Democracy, *Të drejtat dhe përgjegjësitë*, <http://www.living-democracy.al/textbooks/volume-3/part-2/unit-5/lesson-3/>, (qasur më: 15.09.2018)

³⁸ David Archard, *Children Rights and childhood*. Second Edition. (London and New York: Routledge, 2004), p. 57

Sipas kësaj Karte, fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë ndaj rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilave ata ekspozohen. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për mbrojtje të përshtatëshme ekonomike, juridike dhe sociale.³⁹

Neni 17 i Kartës Sociale Evropiane parasheh të drejtë e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje ekonomike, ligjore dhe sociale.

Karta përcakton disa nga të drejtat dhe liritë e njeriut dhe krijon një mekanizëm mbikëqyrës që garanton respektimin e tyre nga shtetet palë. Ajo garanton të drejtat dhe liritë të cilat u përkasin të gjithë individëve në ekzistencën e tyre të përditshme.

Të drejtat themelore të përcaktuara në Kartën Sociale Evropiane janë: strehimi, shëndetësia, arsimi, punësimi, mbrojtja sociale dhe ligjore, lëvizjen e lirë e personave dhe jo-diskriminimi.

Edhe kjo paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm me të cilaën proklamohen dhe mbrohen të drejtat dhe liritë esenciale të fëmijëve.

³⁹ Karta Sociale Evropiane (e rishikuar), Strasburg, 1966, Pjesa I, 7, 17

Kapitulli II

2.1 Dhuna në shkolla në Kosovë

Dhuna, nuk është gjë tjetër pos përdorim i forcës fizike apo edhe i shtrëngimit fizik me anë të metodave të ndryshme për të detyruar dikë të veprojë ose të mos veprojë pa dëshirën e vullnetin e tij.

Fuqia mbi fëmijët ushtrohet duke nxitur, në ndërgjegjen e popullarizuar, frikën për rreziqet që ata pretendojnë se përfaqësojnë.⁴⁰

Dhuna sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, përkufizohet si: "përdorim i vullnetshëm i forcës a fuqisë fizike, si kërcënim ose e aplikuar, kundrejt një tjetri, person ose komunitet duke pasur me gjasë rezultate ose mundësi në dëmtime, vdekje, pasoja psikologjike, keqzhvillim, ose pamundësi", megjithëse grupi është i vetëdijshëm që përfshirja e "përdorimit të forcës" në përkufizimin e vet shtrihet përmbi kuptimit konvencional të fjalës.⁴¹

Nuk mund të lejojmë që ky instinkt të mbisundojë akoma në jetën shoqërore. Një edukim i brezërave i bazuar në parime të shëndosha humane prodhon njerëzimin me vlera dhe ndjenja cilësore që mënjanon dhunën fizike dhe verbale.

Është gjithashtu e rëndësishme që për çdo fëmijë, për çdo adoleshent të mësoj të qeverisë agresivitetin e vet në atë mënyrë që të mos shndërrohet në dhunë.

Dialogu, demokracia dhe të drejtat e njeriut do të kenë vendin e merituar në shoqëri.

Dhuna ndaj fëmijëve është një dhunim i të drejtave të tyre. Dhuna pengon një fëmijë të zhvillojë potencialin e tij/saj të plotë. Mungesa ose prania e dhunës do të ndikojë në suksesin në jetë më vonë. Pasojat e dhunës fizike, emocionale dhe psikologjike mund të ketë shumë ndikim në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijëve dhe në aftësitë e tyre për të mësuar. Në shekullin e 21 nuk ka vend për dhunë ndaj fëmijëve. Gjithsesi ajo vazhdon të shkatërrojë jetë - në çdo vend dhe në të gjithë shtresat e shoqërisë. Një studim mbi dhunën

⁴⁰ Mary John, *Children's Rights and Power Charging Up for a New Century*. (London and New York: Jessica Kingsley Publishers, 2003), p. 37

⁴¹ Violence Prevention Alliance, *Definition and Typology of Violence*, <http://www.who.int/violenceprevention/approach/definition/en/>, (qasur më: 07.10.2018)

ndaj fëmijëve i 2006 në Shqipëri tregon se pjesa dominuese e të rriturve mendojnë se dhuna fizike dhe psikologjike ka ndikim pozitiv në edukimin e fëmijëve. Gjithashtu, 50 përqind e fëmijëve janë mësuar me idenë se dhuna është diçka e mirë në shtëpi edhe në shkollë. Besimi se “Ai që të rreh, të do” është shumë i përhapur tek prindërit, mësuesit, dhe fëmijët. Dhuna fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve në Shqipëri është një fenomen i shpeshtë në shtëpi dhe qendrat e kujdesit rezidencial. Megjithëse qeveria shqiptare ka bërë përpjekje për të reformuar ligjet që trajtojnë dhunën ndaj grave dhe fëmijëve, ka akoma shumë mangësi në legjislacion. Nuk ka asnjë strukturë qeveritare në nivel qendror dhe vendor që të jetë drejtpërdrejtë përgjegjëse për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve. Për më tepër, nevojiten përpjekje për të dokumentuar më mirë prevalencën dhe karakteristikat e dhunës ndaj fëmijëve dhe për të kuptuar më mirë shkaqet e saj.⁴²

Të gjithë ne si pjesë e shoqë e shoqërisë duhet që së bashku të kontribuojmë në uljen e kësaj dukurie negative.

Dhuna në përgjithësi, dhe dhuna në shkolla në veçanti, është e lidhur ngushtë me fenomenin e delikuencës së të rinjve, përhapja e së cilës gjithashtu është në rritje në vitet e fundit dhe është duke marrë përmasa shqetësuese. Hulumtimet e bëra në këtë fushë janë bërë në bazë të intervenimit të ndryshëm të programeve në shkolla tona. Por, ndryshimet e programeve të tilla nuk kanë dhënë rezultatet e pritura. Kërkimet kryesisht janë bërë në arsimin fillor. Prandaj, ka qenë e nevojshme për ta shqyrtuar gjendjen në shkolla dhe raportet në mes nxënësve. Format më të shpeshta të dhunës, janë: ngacmimi, detyrimi, përndjekja, dhuna psikologjike, dëmtimi, shkatërrimi i pasurisë, dhuna fizike... Sado që një veprim i tillë tentohet të arsyetohet nga ushtruesit ose edhe urdhërdhënësit e shtytësve, dhuna rrallë mund të ketë efekte pozitive. Ajo mbjell dhe shkakton frikë, trauma e urrejtje, të cilat lënë plagë të pashërueshme shpirtërore.⁴³

Dukuria e dhunës në shkolla është pasojë edhe e dobësisë së lidhjeve mësues-nxënës-prindër-menaxhment i shkollës, paaftësi e mësuesve për të punuar dhe mungesë e vullnetit për të ndikuar. Mjaft mësues nuk e njohin sa duhet moshën e tyre dhe

⁴² Unicef Albania, *Dhuna ndaj fëmijëve*, https://www.unicef.org/albania/sq/children_28180.html, (qasur më: 07.10.2018)

⁴³ Emrush Thai, *Dhuna në shkolla, alarm për institucionet shkollore!*, <https://telegrafi.com/dhuna-ne-shkolla-alarm-per-institucionet-shkollore/>, 2014, (qasur më: 07. 10.2018)

nuk janë të motivuar sa duhet për të ndikuar në këtë moshë tek fëmijët. Dhuna te fëmijët është pasqyra e asaj që ndodh në shoqëri.

Varfëria ndikon në mënyrën më absolute te sjellja e keqe dhe dhuna. Fëmijët sot janë përherë në një gjendje ankthi, që u krijohet si një tension mes një bote mediatike, e cila me imazhet, produktet që ofron, i bënë ata të ëndërrojnë një botë më të mirë, në kundërshtim me mundësitë për t'iu afruar këtij sistemi vlerash. Dhuna dhe huliganizmi në mjediset edukativo-arsimore në Kosovë, tashmë janë bërë dukuri shqetësuese duke marrë edhe jetë fëmijësh.⁴⁴

Dukuria e prezencës së dhunës në shkolla është rezultat i gërshetimit të faktorëve të ndryshëm me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare. Këta faktorë mund të jenë ekonomik dhe social.

Në vazhdim do i përmbledhë dhjetë (10) aktivitete për ndërprerjen e dhunës në shkollë.⁴⁵

1. Përfaqsoni qasje me nxënësit, kuadrin shkollorë, prindërit dhe bashkësinë;
2. Bëni nxënësit partnerin tuaj në parandalimin e dhunës;
3. Përdorni metoda dhe masa konstruktive dhe disiplinore;
4. Bëhuni fuqi efektive dhe aktive për parandalimin e maltremit;
5. Ndërtoni qëndrueshmëri te nxënësit dhe ndihmohuni që në mënyrë konstruktive tju përgjigjen sfidave në jetë;
6. Bëhuni shembull pozitiv me atë që zëshëm do ti kundërviheni dhunës seksuale dhe gjinore;
7. Sakrifikoni për mekanizma të sigurisë në shkollë;
8. Siguroni vende të sigurta kun xënësit do të jenë të mirëseardhur;
9. Mësoni shkathtësi për ndalimin e dhunës dhe zgjidhjen e konflikteve dhe mësoni nxënësit;
10. Shqyrtoni dhunën dhe diskriminimin kundër nxënësve me invaliditet dhe kundër atyre të cilët u takojnë vendasve, pakicave dhe bashkësive tjera të marginalizuara.

⁴⁴ Emrush Thai, *Dhuna në shkolla, alarm për institucionet shkollore !!!*, <https://telegrafi.com/dhuna-ne-shkolla-alarm-per-institucionet-shkollore/>, 2014, (qasur më: 07. 10.2018)

⁴⁵ Unicef, *Ndërprerja e dhunës nëpër shkolla*, https://www.unicef.org/tfymacedonia/Priracnik_za_nasilstvo_-_ALB.pdf, (qasur më: 07.10.2018)

Duhet kontribut dhe mobilizim i përbashkët në mënyrë që dhuna të minimizohet dhe ta humb efektin e saj në fëmijët tanë e sidomos në institucionet edukativo-arsimore.

Sipas një hulumtimi të kryer nga “KIPRED”, konstatohet se, përballë zvogëlimit të dhunës fizike dhe psikike të mësimdhënësve mbi nxënës, kemi një rritje rapide të keqtrajtimit të fëmijëve nga fëmijët moshatarë. Keqtrajtimi i fëmijëve nga fëmijët moshatar në vitin 2003, ka qenë dukuri e rastit me një përqindje më të vogël se një përqind, ndërsa tani delikuenca e të miturve është 7.4%. Është më e madhe se sa dhuna fizike e mësimdhënësve mbi nxënës. Nëse nuk hartohet një projekt për parandalimin e keqtrajtimit të fëmijëve nga fëmijët treguesit do të rriten në mënyrë rapide, kështu që mjediset në shoqëri do të jenë edhe më të dhunshme dhe pengesë serioze për demokratizimin e shoqërisë kosovare. Poashtu bashkëpunimi ndërmjet organeve dhe organizatave të ndryshme të shoqërisë civile dhe të institucioneve formale nuk është në nivelin e duhur. Mosbashkëpunimi i programuar dhe i koordinuar vështirëson punën në krijimin e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/ miqësore në shoqëri dhe në shkolla Ky hulumtim i shpejtë i gjendjes së nxënësve në Kosovë, na ka krijuar mundësinë që të vërtetojmë hipotezën gjenerale se: “Në Kosovë, mjediset nuk janë të sigurta, jo të dhunshme dhe humane/ miqësore në masë që ato të jenë hapësira të përshtatshme për zhvillimin e plotë të personalitet të fëmijës dhe të vendosjes së njeriut – fëmijës në qendër”, sidhe nënhipotezën: “Dhuna mbi fëmijë në shoqëri dhe në shkolla është akoma e përhapur në masën që kalon 40% të fëmijëve në Kosovës”.⁴⁶

Mësuesit duhet të kujdesen që rregullat nuk duhet të jenë arbitrare në raport me nxënësit. Përdorimi i metodave të dhunshme do të kishte për pasojë pengimin e zhvillimit të përgjegjësisë individuale pasi dobëson mundësitë për një demokraci autentike dhe zgjedhje reflektuese.⁴⁷

Në shoqërinë shqiptare dhe jo vetëm, janë bërë shumë studime mbi dhunën. Në intervistimet e shumta, nxënësit e shikojnë dhunën si formë edukimi, madje edhe në familje. Përdorimi i dhunës nuk ndjehet as kur ajo shtrihej përtej kufijve të familjes, në shkollë, as kur vjen nga vetë nxënësit mbi nxënësit. Ajo që rezulton është se dhuna në

⁴⁶ KIPRED, *Hulumtim me temën Dhuna në Shkolla*, 2013, f. 5

⁴⁷ Betty A. Reardon, *Educating for Human Dignity Learning About Rights and Responsibilities*. (Philadelphia: Pennsylvania Studies in Human Rights, 1995), f. 80

shkollë merr trajta e forma nga më të ndryshmet, buron nga të gjithë anëtarët e shkollës, konturet e saj janë gjithëpërfshirëse, horizontale dhe vertikale. Bashkë me paqartësinë mbi dhunën, është lehtë të evidentohen edhe qëndrimet ndaj saj. Janë në fakt qëndrime shumë të çuditshme! Dhe jo vetëm ndaj dhunës “moderne”, asaj psikologjike e emocionale, po edhe ndaj dhunës “tradicionale”, asaj të së shkuarës, të shëmtuarës, dhunës fizike! Disa herë përsëritet që “druri ka dalë nga xheneti!”, apo “kush të rreh të do!”.⁴⁸

Për dhunën në shkolla flasin edhe vetë fëmijët, të cilët tregojnë se dhuna është përditshmëri.

Dhuna fizike dhe psikike në institucionet edukativo-arsimore, mbetet një problem shqetësues për shoqërinë e Kosovës.

Shkolla është një institucion edukativo-arsimor për fëmijët tanë. Krijimi i një mjedisi të sigurt për nxënësit pa frikën nga sjelljet e dhunshme dhe jo njerëzore, është një sfidë relativisht e madhe për shoqërinë dhe para se gjithash një kusht elementar për ngritjen sigurisë dhe cilësisë së arsimit në vendin tonë.

Fëmijët mësojnë më mirë në një ambient ku ata nuk ndihen inferior. Shkolla, mësuesja duhet të promovojë dialogun dhe diskutimin e hapur duke i parë fëmijët si partner dhe të barabartë.

Fëmijët, gjithashtu duhet të ndërgjegjësohen për vlerën e një sjellje të mire duke krijuar marrëdhënie respekti reciprok. Kjo do t'i ndihmonte ata që të zbulojnë dhe zhvillojnë më mirë identitetin e tyre. Për të arritur këtë, fëmijët duhet të ndihen të pranuar, të respektuar, të mbrojtur, të lirshëm, të barabartë në ambientet e shkollës dhe klasës pjesë e së cilës ata janë. E drejta e fëmijëve për t'u dëgjuar dhe përfshirja e tyre në vendimmarrje do të sillte një përmirësim të dukshëm dhe do të ndihmonte për një edukim gjithëpërfshirës. Mirëqenia e fëmijës është e rëndësishme. Në të gjitha ligjet dhe vendimet juridike, mirëqenia e fëmijës është parësore.


Lidhur me rastet e aplikimit të dhunës në shkolla në Kosovë, kemi realizuar një pyetësor me nxënës të moshës 12-15 vjeç në dy shkolla fillore në Prizren. Janë intervistuar gjithsejt 80 nxënës. Të anketuarit i përkasin gjinisë femrore dhe mashkullore. Të anketuarit janë pyetur se:

⁴⁸ Behare Rexhepi, *Çfarë sjell dhuna e përdorur në shkollë ?* <https://telegrafi.com/cfare-sjell-dhuna-e-perdorur-ne-shkolle/>, 2009, (qasur më: 08.09.2018)


1. *A ushtrohet dhunë në shkollën tuaj ?*
2. *Cila është forma e dhunës së ushtruar, fizike apo psikologjike ?*
3. *Cilat janë format e dhunës fizike e cilat të dhunës psikologjike ?*
4. *Si mendoni, dhuna ushtrohet më tepër në femra apo meshkuj ?*
5. *Çfarë përjetojnë fëmijët që bien pre e dhunës ?*
6. *Cilët janë faktorët që e nxitin dhunën në shkollë ?*

Bazuar në analizat e hulumtimit dhe të dhënat e përfituara:

1. **A ushtrohet dhunë në shkollën tuaj**, konkludojmë se dhuna është e përhapur në shkolla dhe se nxënësin bien pre e dhunës qoftë si viktimë e dhunës qoftë si dëshmitar të cilët shohin raste të ushtrimit të dhunës ndaj shokëve/shoqeve të tyre. Nga 80 nxënës të anketuar, 80% e tyre u shprehën se ushtrohej dhunë në shkollën e tyre kurse 20% u shprehën që nuk ushtrohej dhunë.



2. **Cila është forma e dhunës së ushtruar, fizike apo psikologjike ?** Në këtë pyetje, nxënësit e anketuar thonë se 40% të rasteve është përdorur dhunë fizike kurse 60% e tyre thonë se ndaj tyre është ushtruar dhunë psikologjike.



3. Cilat janë format e dhunës fizike e cilat të dhunës psikologjike ?

Në tabelat mëposhtme janë të shënuara format e dhunës fizike dhe asaj psikologjike të shprehura në %.

Format e dhunës (bulizmit) fizik:


Format e bulizmit fizik të ushtruar nga nxënësit	Nr i nxënësve
Goditje me shpullë në kokë	37.3%
Goditje me shpullë në pjesë të tjera të trupit	36.9%
Shkulje flokësh	23.5%
Goditje me objekt	39.3%
Goditje me grusht	18.7%
Shtrengim për fyti	9.9%
Tëreqje dhe shtytje me forcë	44.8%

Format e dhunës (bulizmit) psikologjik:

Format e bulizmit psikologjik në shkollë	Nxënësit në %
Të bërtitur	59%
Mallkim	41%
Sharje	27%
Kërcënim	23%
Refuzim	16%
Poshtërim	15%
Shfrytëzim	24%


4. Si mendoni, dhuna ushtrohet më tepër në femra apo meshkuj ?

Dhuna ushtrohet në të dyja gjinitë pa dallim, pra, edhe në femra edhe në meshkuj. Bazuar në rezultatet e anketës, rreth 60% ushtrohet në femra ndërsa 40% tek meshkujt.




5. Çfarë përjetojnë fëmijët që bien pre e dhunës ?

Në këtë pyetje, nxënësit u përgjigjen me alternativa: depresion (23%), nota të dobëta (30), mendime për vetvrasje (5%), ndjenja faji (17%), agresivitet (15%), probleme në sjellje (5%), ulje e vetëbesimit (5%).



6. Cilët janë faktorët që e nxitin dhunën në shkollë ?

Edhe në këtë pyetje nxënësit u përgjigjen me alternativa duke thënë se dhunë nxisin: huliganët (30%); mësimdhënësit (20%); drejtori (15%); bashkëmoshatarët (15%); testet (20%).



Studimet analitike të rezultateve të hulumtimeve të bëra tregojnë se gjendja e mjediseve të tashme në Kosovë është e pasigurtë, me shumë elemente të dhunës. Kjo gjendje, këto mjedise, i bënë johumane dhe jomiqësore jo vetëm për fëmijë, por edhe për të rritur.

Treguesi tjetër i fuqishëm i theksuar nga mësimdhënësit, që është më i dukshëm dhe që rezulton nga edukimi për të drejtat e fëmijëve është pikërisht mjedisi miqësor dhe human i krijuar në shkolla.

2.2 Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës

Ky instrument konsiderohet si një prej dokumenteve bazike për mbrojtjen e të drejtave të fëmije. Konventa për të Drejtat e Fëmijës miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj 44/25 të datës 20 nëntor 1989. Ka hyrë në fuqi: 2 shtator 1990.

Më detajisht, rreth përmbajtjes së kësaj Konvente, kemi bërë fjalë në kapitullin e parë, konkretisht në zhvillimin historik të të drejtave të fëmijëve si dhe në kronologjinë e të drejtave të fëmijëve.

Përveç të drejtave, ky dokument përmban edhe detyrime. Çdo njeri në botë ka të drejtat e tij. Gjërat më të rëndësishme në botë janë: Liria, Drejtësia dhe Paqja. Këto arrihen duke respektuar të drejtat e të gjithë njerëzve. Të gjithë njerëzit në botë janë të ndryshëm nga raca, gjinia, feja, mendimet politike etj. Të gjithë ata kanë të drejta të barabarta.. Familja është vendi më i mirë ku mund të rritet fëmija. Familja duhet të ndihmohet dhe të mbrohet nga shteti që ta edukojë fëmijën sa më mirë. Që të rritet sa më mirë, familja duhet t'i sigurojë atij dashuri, ngrohtësi dhe mirëkuptim. Fëmija duhet të përgatitet për të përballuar jetën në shoqëri. Dhe për këtë ai duhet të mësojë të jetë tolerant, të jetojë në paqe, në liri dhe të sillet me të tjerët në mënyrë të barabartë.⁴⁹

Kjo Konvent garanton të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim, interesin më të lartë të fëmijës, përgjegjësinë e shtetit për të drejtat e fëmijës, udhëheqjen prindërore dhe zhvillimin e aftësive të fëmijës, të drejtën për mbijetesë dhe zhvillimin, të drejtën për të pasur emër dhe shtetësi, të drejtën për identitet, të drejtën për të jetuar me të dy prindërit, të drejtën për shprehjen e mendimit lidhur me familjen, të drejtën e ndërgjegjes dhe fesë, të drejtën për jetë private, mbrojtjen nga keqtrajtimi, të drejtat e fëmijëve refugjatë, pakicave etnike, të drejtën për përkujdesje shëndetësore, të drejtën në arsim, mbrojtjen nga abuzimi seksual, mbrojtja nga trafikimi, të drejtat e fëmijëve në konflikte të armatosura, mbrojtjen e lirisë, të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin.

Instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare adresojnë të drejtën për një shtetësi. Neni 15 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj) parashikon se çdokush ka të drejtën e një shtetësie dhe se askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij. E drejta e çdo fëmije për të fituar një shtetësi u ngrit në vijim si çështje edhe në Paktin e vitit 1966 mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR). Neni 24 thotë se: “Çdo fëmijë duhet të ketë, pa asnjë diskriminim ndaj racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë ose lindjes, të drejtën për masa të tilla mbrojtëse që kërkojnë kushtet e tij si i mitur, nga ana e familjes së tij, shoqërisë dhe shtetit.” “Çdo fëmijë duhet të

⁴⁹ Save the Children, *Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, Për Fëmijët nga Fëmijët*, 2002, f. 9

regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe duhet të ketë një emër.” “Çdo fëmijë ka të drejtë për të fituar një shtetësi.”⁵⁰

Duke u bazuar në respektin për dinjitet të të gjitha qenieve njerëzore, KDF e njeh çdo fëmijë si bartës të të drejtave të tij njerëzore: këto të drejta nuk rrjedhin apo ndërvaren nga të drejtat e njeriut apo ndonjë të rrituri tjetër. Kjo është mbështetja për konceptin e autorizimit të fëmijës, duke i mundësuar fëmijës si një subjekt i respektuar dhe qytetar i shoqërisë, që të sfidojë dhe të ndërrojë kufizimet e perceptimeve diskriminuese dhe pritjet nga të rinjtë. Faktikisht, fëmijët mbeten të varur nga të rriturit (falë zhvillimi të tyre fizik dhe psikik, mungesa e të mirave materiale/të ardhurave dhe ndryshimeve në situatat ekonomike dhe sociale të prindërve si papunësia, shkurorëzimi i prindërve etj.), të që kanë ndikim të mënjëhershëm në standardin e jetesës të fëmijës.⁵¹

KDF si unik është traktati i parë universal për të drejtat e njeriut që kombinon të drejtat ekonomike, sociale, kulturore, si dhe ato civile dhe politike në një dokument të vetëm. KDF ndjek një qasje gjithëpërfshirëse për adresimin e situatës për fëmijë; ai shkon përtej deklaratave më të hershme për fëmijë, të cilat ishin fokusuar në nevojat e mbrojtjes gjatë zhvillimi të fëmijës, si dhe përfshin kushtet e garantimit të respektit për identitetin e fëmijës, vetëvendosjes dhe pjesëmarrjes.⁵²

Pas miratimit të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës më 1989, në vitin 1990 është miratuar një Kartë Afrikane për të Drejtat dhe Mirëqenien e Fëmijës. Sidoqoftë, kjo ka hyrë në fuqi vetëm në vitin 1999, kurse deri në vitin 2001, atë e kanë ratifikuar 27 shtete të Unionit Afrikan. Karta Afrikane parashikon edhe themelimin e një Komiteti Afrikan të Ekspertëve për të Drejtat dhe Mirëqenien e Fëmijës, i cili duhet të mblidhet së paku një herë në vit.⁵³

Të gjitha masat që ndërmerren për fëmijë, qofshin ato të marra nga institucionet publike apo nga ato private të përkujdesjes sociale, nga gjyqet, nga autoritetet e

⁵⁰ Marilyn Achiron, *Shtetësia dhe Pashtetësia*, <http://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain/opendocpdf.pdf?reldoc=y&docid=5469fad84>, 2014, (qasur më: 03.09.2018)

⁵¹ Të drejtat e fëmijës, http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/albanian/child/child.htm, (e qasur më: 17.08.2018)

⁵² Po aty

⁵³ Hyrje në sistemin e të drejtave të njeriut, http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/albanian/I_Intro/introduction.pdf, (qasur më: 12.09.2018)

administratës apo nga organet legislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë synimi mbizotërues.⁵⁴

Fëmijët janë qëniet më të sinqerta dhe të mrekullueshme në botë, prandaj edhe jeta e tyre duhet të jetë e përsosur.

Çdo shtet duhet të sigurojë, në maksimumin e mundësive të tij, zbatimin e të drejtave të fëmijës.

2.3 Konventa europiane për të drejtat e fëmijëve “Për Marrëdhëniet me Fëmijët” dhe “Mbi ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve”

Konventa Europiane “Për Marrëdhëniet me Fëmijët”, ka përcaktuar këto objektiva:⁵⁵

- Përcaktimin e parimeve të përgjithshme për t’u zbatuar në lidhje me vendimet mbi marrëdhëniet;
- Rregullimin e garancioneve të përshtatshme për të siguruar ushtrimin e rregullt të marrëdhënieve dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijëve në fund të afatit të marrëdhënies;
- Vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet organeve qendrore, gjyqësore dhe organeve të tjera për të nxitur dhe përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët.

Kjo Konventë e vë theksion se interesat e fëmijës janë prioritare. Poashtu, kjo Konventë parasheh edhe të drejtat e fëmijëve me prindër të ndarë, që të mbajë kontakte të rregullta me të dy prindërit, përveç nëse një gjë e tillë është në dëm të fëmijës dhe kundër interesave të tij.

⁵⁴ Wolfgang Benedek, *Kuptimi i të Drejtave të Njeriut*. (Prishtinë: Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës, 2014), f. 291

⁵⁵ INFOÇIP, *Konventa Europiane “Për Marrëdhëniet me Fëmijët”*, <http://www.infocip.org/al/?p=3221>, (qasur më: 07.10.2018)

Ndër të tjerash, Konventa në fjalë, ka bërë zëvendësimin e konceptit “e drejta e vizitës tek fëmijët” me nocionin “marrëdhëniet me fëmijët”.

Nga këndvështrimi i të drejtave të fëmijëve “Konventa e Këshillit të Evropës “Për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, ka efekt të drejtpërdrejtë në aspektet e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave më të mira të fëmijëve nëpërmjet marrjes së masave konkrete në favor të tyre. Qëllimi i kësaj konvente është që të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese, që në favor të mbrojtjes së interesave më të mira të fëmijëve, të marrin masa për të promovuar të drejtat e tyre, t’u japin atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime që ndikojnë tek ata para një autoriteti gjyqësor.⁵⁶

Dispozitat e saj paraqesin masat procedurale për të promovuar ushtrimin e të drejtave të fëmijëve, si të drejtat procedurale të fëmijëve ku përfshihen: E drejta për t’u informuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij ose të saj në procedim, e drejta për të aplikuar për emërimin e një përfaqësuesi të veçantë, të drejta procedurale shtesë fëmijëve në lidhje me procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ata, roli i autoriteteve gjyqësore i cili lidhet drejtpërdrejt me procesin e vendimmarrjes, detyrimi për të vepruar shpejt, detyrimi për të vetëvepruar, detyrimin për emërimin e një përfaqësuesi për fëmijën. Gjithashtu në këtë kapitull parashikohet edhe roli i përfaqësuesit, i cili siguron të gjithë informacionin përkatës për fëmijën, nëse fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm; përcakton pikëpamjet e fëmijës dhe ia paraqet këto pikëpamje autoritetit gjyqësor.⁵⁷

Konventa angazhon shtetet palë, që nëpërmjet organeve të tyre kombëtare të nxisin promovimin dhe ushtrimin e të drejtave të fëmijëve. Këto organe nxiten të bëjnë propozime për të forcuar ligjin në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe të japin mendime në lidhje me projekt legjislacionin mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.⁵⁸

⁵⁶ Ligj Nr.10 425, Datë 2.6.2011 Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve”

⁵⁷ Ibidem

⁵⁸ Ibid.

Sipas instrumenteve të lartëcekura, të drejtat e fëmijeve gëzojnë mbrojtje të fuqishme, duke i dhënë primatin këtyre të drejtave dhe përmes këtij fokusi të parandalohen pasojat në shoqërinë tonë të cilat mund të jenë edhe fatale.

2.4 Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve

Tashmë është fakt notor që, një qershori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur dhe ta festojnë këtë ditë me prindërit e tyre dhe pranë familjes së tyre.

Kjo ditë është kthyer jo vetëm në një ditë festive, por edhe në një ditë sensibilizimi, për ti thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është dita kur vetë fëmijët ngrenë zërin për të drejtat e tyre, por në ndryshim nga të rriturit, protesta e tyre bëhet me lojra festive.

Dita e fëmijëve u vendos në datën 1 qershor, sepse në këtë datë është mbajtur Konferenca Botërore e Mirëqënies së Fëmijëve në Gjenevë, në 1925. Në të njëjtën ditë, koinçidoi që konsulli i përgjithshëm kinez në San Francisko mblodhi së bashku një numër të konsiderueshëm fëmijësh jetim kinezë të celebronin në festivalin e “Anijes së Dragoit”. Dy vjet më pas Festa e 1 qershorit filloi të festohet në të gjithë botën.⁵⁹

Objektivi ynë është të pakësojmë dhunën ndaj fëmijëve si në familje, dhe në shoqëri, dhe të kontribuojmë në krijimin e një mjedisi optimal për zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijëve.

Që prej dhjetorit të vitit 1954, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, ka rekomanduar të gjitha shtetet të kenë një ditë të instucionalizuar si Dita Universale e të Drejtave të Fëmijëve. Qëllimi i kësaj dite është respektimi si një ditë e vëllazërisë dhe mirëkuptimit mes fëmijëve në të gjithë botën. 20 nëntori është shënuar në kalendar si “Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve”.⁶⁰

⁵⁹ Awareness day UK, *International Children's Day 2018*, <https://www.awarenessdays.com/awareness-days-calendar/international-childrens-day-2018/>, (qasur më:08.08.2018)

⁶⁰ Gazeta KNN, *Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve*, 2017, <http://aab.edu.net/media/gazetaknn/dita-nderkombetare-e-te-drejtave-te-femijeve/>, (qasur më: 08.09.2018)

Përcaktimi i kësaj dite ka marrë shkas nga Konventa për të drejtat e fëmijëve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 20 Nëntor 1989. Gjithashtu kjo ditë ka për qëllim të jetë ditë aktivitetesh për të promovuar idealet dhe objektivat e Kartës për të Drejtat e Fëmijëve si dhe mirëqënien e fëmijëve të botës. Data 20 nëntor, përkon me ditën e miratimit të Deklaratës për të Drejtat e Fëmijëve në vitin 1959, si dhe miratimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në vitin 1989. Sipas Konventës, e cila është marrëveshja më e ratifikuar në të gjithë botën, për të drejtat e njeriut, përfshin të drejtën e jetës, të drejtën e shëndetit, edukimit dhe për të luajtur. Gjithashtu të drejtat për të patur një familje, për t'u mbrojtur nga dhuna dhe diskriminimi.⁶¹

Koncepti i të drejtave të fëmijëve ka evoluar nga njëra anë nga lëvizja e gjerë për të drejtat e njeriut, por poashtu ka rrjedhur nga zhvillimet e tjera në fushën sociale, arsimore dhe psikologjike në 300 vitet e fundit. Këtu përfshihen edhe ndikimi i përkrahjes institucionale shtetërore për arsim të obliguar në shkollë, efektet negative të industrializimit në fëmijë (për shembull shpërdorimi i fëmijëve në fabrika apo miniera) dhe pasojat e luftës. Një kuptim i ri mbi zhvillimin e fëmijës ka evoluuar, nga koncepti i ri i mësimi dhe modelet e ngritjes së fëmijës në “lëvizje liberale fëmijërore” në vitet e ‘70. Ata ndihmuan që ta zhvendosnin cënueshmërinë e fëmijës dhe nevojat e mbrojtjes në një diskutim të ri mbi autonominë e fëmijës, kompetencën, vetëvendosje dhe pjesëmarrjen e fëmijës, duke i refuzuar botëkuptimet atërore të fëmijëve si objekte të kontrollit prindor/madhor. Përfundimisht, të gjitha këto zhvillime së bashku kanë pasur një ndikim të madh në proceset politike, të cilat filluan brendapërbrenda Kombeve të Bashkuara: skicimi i një trupi të ri ligjor detyrues për të drejtat njerëzore të fëmijës – Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Viti i miratimit të saj - 20 Nëntori 1989 – është përvjetori i *Ditës Ndërkombëtare të të Dejtave të Fëmijës*.⁶²

Në vitin 1979 gjatë seancës së 31-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara u shpall Viti Ndërkombëtar i Fëmijëve (IYC). Të gjitha vendet e botës u inkurajuan për të lënë mënjanë problemet tjera dhe për ta përqendruar vëmendjen në 1.5 miliardë fëmijët në mbarë botën. Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)

⁶¹ Gazeta KNN, *Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve*, 2017, <http://aab-edu.net/media/gazetaknn/dita-nderkombetare-e-te-drejtave-te-femijeve/>, (qasur më: 02.09.2018)

⁶² Të drejtat e fëmijës, http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/albanian/child/child.htm, (qasur më: 17.08.2018)

drejtoi IYC, i cili kryesohej nga Estefania Aldaba-Lim, nga Filipinet. Një total prej 151 kombeve morën pjesë në IYC. Në Shtetet e Bashkuara, Presidenti Jimmy Carter nënshkroi një urdhër ekzekutiv duke krijuar një Komision Kombëtar për Vitin Ndërkombëtar të Fëmijëve, të cilin e quajti Jean Childs Young. Komisioni, i përbërë nga qytetarët dhe anëtarë të Kongresit, inkurajoi të gjithë amerikanët për të zhvilluar një nivel të ri të vetëdijes për nevojat e veçanta të fëmijëve, që të rriten në një shoqëri komplekse dhe shumë konkurruese. Për të arritur këtë rezultat, Komisioni ka promovuar dhe koordinuar aktivitetet e agjencive federale qeveritare dhe më shumë se 400 organizatave kombëtare. Ai gjithashtu ka iniciuar dhe publikuar aktivitetet dhe programet që lidhen me mirëqenien e fëmijëve nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me qeveritarët, kryetarët e komunave, udhëheqësit e shoqërisë civile, grupet e avokimit, krerët e organizatave kombëtare dhe korporatat dhe vetë fëmijët. Kongresi ka ndarë fonde për Komisionin, kështu që të gjitha aktivitetet janë financuar nga qeveritë lokale ose donatorët privatë. Aktivitetet e sponsorizuara nga Komisioni dhe anëtarët e tij shkonin nga parada dhe ekspozitat e artit, seminare mbi abuzimin e fëmijëve dhe kujdesin shëndetësor për të rinjtë. Spanja vendos një dispozitë të veçantë në Kushtetutën e saj, të shpallur më 27 dhjetor 1978, duke thënë: "Fëmijët do të përfitojnë nga mbrojtja e përcaktuar në marrëveshjet ndërkombëtare të destinuara për të mbrojtur të drejtat e tyre."⁶³

Të gjithë duhet të vazhdojmë të punojmë për t'ë krijuar një ambient të favorshëm për ndryshim. Ndryshimi nuk vjen vetëm nga jashtë, por vjen nga brenda. Fëmijët duhet të përpiqen çdoherë shumë e më shumë. Në veçanti duhet të dënohet diskriminimi dhe dhuna ndaj fëmijëve.

2.5 Organizatat për të Drejtat e Fëmijëve që veprojnë në Kosovë (UNICEF, Save the Children)

Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë veprojnë organizata jo qeveritare si vendore, ashtu edhe organizata ndërkombëtare. Këtu do të ndalemi në organizatat

⁶³ The Robinson Library, *International Year of the Child*, <http://www.robinsonlibrary.com/social/family/family/childyear.htm>, (qasur më: 16.09.2018)

kryesore që veprojnë në këtë fushë, si Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) dhe Save the Children.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i themeluar në Qershor të vitit 2011, është një koalicion i përbërë nga 27 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.⁶⁴

Misioni i Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve është mbrojtja, respektimi, mirëqenia dhe avancimi i të drejtave të fëmijëve. Kjo realizohet nëpërmjet lobimit dhe avokimit për promovimin dhe zhvillimin e të drejtave të fëmijëve sipas KDF-së.⁶⁵

Objektivat kryesore të Koalicionit janë:⁶⁶

- Nxitja e miratimit të ligjeve dhe politikave për fëmijët.
- Monitorimi i zbatimit të ligjeve dhe politikave kombëtare për fëmijët.
- Sensibilizimi dhe mobilizimi i autoriteteve shtetërore relevante në nivel lokal dhe nacional, sensibilizimi i ofruesve të shërbimeve dhe i aktorëve të tjerë në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Rritja e vetëdijesimit tek opinioni i gjerë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve pa dallim.
- Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të gjitha grupeve që janë më të ekspozuara ndaj shkeljes së të drejtave të fëmijëve.
- Krijimi i hapësirave për zhvillimin e praktikave më të mira, në fushën e të drejtave të fëmijëve, dokumentimi dhe ndarja me të gjithë anëtarët e koalicionit.
- Fuqizimi i kapaciteteve të koalicionit, veçanërisht fuqizimi i organizatave lokale dhe organizatave të bazuara në komunitet.

KOMF në mënyrë të vazhdueshme, pranon kërkesa të reja nga organizata të ndryshme në Kosovë për anëtarësim.

⁶⁴ KOMF Koalicioni i Qeverive për Mbrojtjen e Fëmijëve, <http://www.komfkosova.org/misioni/>, (qasur më: 08.08.2018)

⁶⁵ Ibidem

⁶⁶ Ibid.

Një Organizatë tjetër e cila i mbrohet të drejtat e fëmijëve është edhe UNICEF i njohur si Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët.

UNICEF-i është i mandatuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve, për të ndihmuar në përmbushjen e nevojave të tyre themelore dhe për të zgjeruar mundësitë e tyre për të arritur potencialin e tyre të plotë. UNICEF-i në Kosovë synon të sigurojë që të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre socio-ekonomike ose etnike, të kenë qasje në shërbime cilësore dhe miqësore dhe mundësi për t'i ndihmuar ata të mbijetojnë, zhvillojnë, pasurojnë potencialin e tyre dhe të bëhen qytetarë aktivë dhe përgjegjës të komuniteteve të tyre.⁶⁷

Duke mos e anashkaluar asnjë fëmijë, UNICEF është e angazhuar për të jetësuar sfidat më të vështira për t'u arritur, fëmijë më pak të rrezikuar dhe më pak të dukshëm që vuajnë nga forma të shumta të përjashtimit. Puna e UNICEF-it merr një qasje shumë-sektoriale e cila integron strategjitë e edukimit, shëndetësisë, mbrojtjes së fëmijëve, përfshirjes dhe reduktimit të dhunës dhe i kombinon këto në bashkëpunime strategjike me institucionet e Kosovës dhe partnerët e tjerë për të siguruar prioritetet e investimeve në zhvillimin e kapitalit njerëzor. UNICEF-i përkrah institucionet e Kosovës për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator në fushën e të drejtës së fëmijëve, duke e përshtatur atë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.⁶⁸

Përmes investimeve strategjike, ngritjes së kapaciteteve dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe mediat, fuqizimin e fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve, UNICEF është duke krijuar një të ardhme të re për Kosovën ku konflikti i së kaluarës i hap rrugën prosperitetit, duke siguruar që fëmijët të lindin sot në Kosovë kanë një shans për të arritur ëndrrat e tyre dhe për të arritur potencialin e tyre të plotë. Përmes aktivitetit të Innovations Lab, UNICEF avancohet përdorimin e teknologjisë dhe shqyrtojmë se si të bëjmë ndryshimin përmes komunikimit tek një brez i ri i mbajtësve të të drejtave.⁶⁹

Pra, Unicef, prezanton fondin e Kombeve të Bashkuara për t'i dalë në ndihmë fëmijëve.

⁶⁷ UNICEF Kosovo (under UNCS Resolution 1244), *Programme in Kosovo*, https://www.unicef.org/kosovoprogramme/whoweare_30043.html, (qasur më: 07.09.2018)

⁶⁸ Ibidem

⁶⁹ Ibid.

Një organizatë tjetër që ndihmon në të drejtat e fëmijëve është edhe Save the Children.

Save the Children vepron në Kosovë që nga viti 1997, me një zyrë kryesore në Prishtinë dhe një zyrë në Mitrovicë veriore. Më 1 prill 2012, Kosova u transferua në Save the Children International. Qasja e programit bazohet në ndërhyrjet e drejtpërdrejta dhe vendosjen e praktikave të mira, ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe bartësit e përgjegjësive vendore për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijëve. Gjithashtu, Save the Children, avokon për legjislacionin dhe politikat që do të inkorporojnë praktikat gjithëpërfshirëse dhe do të kenë mekanizma të përshtatshëm financiarë për të mbështetur përgjigjet sistematike dhe për rrjedhojë të arrijnë ndryshime pozitive afatgjata për të gjithë fëmijët. Fëmijët vetë janë pjesëmarrës aktivë në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e punës së kësaj organizate.⁷⁰

Kosova është një vend në tranzicion, edhe pas shpalljes së pavarësisë nga Kosova në vitin 2008, Kosova ende vazhdon të jetë një vend i brishtë në parametra dhe segmente të ndryshme të shoqërisë. Nivelet e larta të varfërisë (që jetojnë më pak se 1.55 euro në ditë), dhe rreth 12% që jetojnë në varfëri të skajshme - më pak se 1 euro në ditë), shkalla e lartë e papunësisë, gjendja shumë e vështirë ekonomike dhe sociale, kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e fëmijës dhe në sigurimin e një mjedisi mbrojtës, cilësor dhe shërbime të qëndrueshme për mirëqenien e fëmijës. Fokusi i partive politike dhe qeverisë gjatë këtyre viteve të fundit ishte më shumë i orientuar drejt investimit të çështjeve më të dukshme si ndërtimi i institucioneve, zhvillimi i infrastrukturës, çështjet ndërkombëtare dhe privatizimi. Kosova / o supozohet të ketë popullatën më të re në Evropë, ku gjysma e popullsisë është nën moshën 25 vjeçare (600,000 fëmijë nga 1.7 milion banorë - sipas zyrës statistikore në Kosovë). Informata të kufizuara statistikore janë të disponueshme për fëmijët në Kosovë, megjithatë të gjitha shifrat në dispozicion janë vlerësime.⁷¹

Sipas Bankës Botërore, varfëria e skajshme është shumë e lartë në mesin e fëmijëve, të moshuarve, familjeve me anëtarë me aftësi të kufizuara dhe familjeve me kryefamiljare. Pakicat etnike të Kosovës janë veçanërisht të prekshme nga varfëria ekstreme si më e larta në mesin e familjeve rome dhe sllave muslimane. Çështja kryesore e situatës së fëmijëve

⁷⁰ Save the Children in Kosovo, <https://kosovo.savethechildren.net/about-us>, (qasur më: 10.08.2018)

⁷¹ Save the Children in Kosovo, <https://kosovo.savethechildren.net/what-we-do>, (qasur më: 10.08.2018)

është varfëria. Në raportin e UNICEF-it për varfërinë e fëmijëve në Kosovë, studimet tregojnë qartë se fëmijët janë në rrezik dukshëm më të madh të varfërisë në Kosovë krahasuar me popullsinë e përgjithshme, ku 48.6% e fëmijëve të moshës 0-18 vjeç raportojnë se jetojnë në varfëri.⁷²

Fëmijët më të rrezikuar në Kosovë janë:

- Fëmijët nga grupet etnike të marginalizuara (sidomos fëmijët e komunitetit rom dhe ashkali dhe egjiptian);
- Fëmijët që jetojnë në varfëri të skajshme;
- Fëmijët që punojnë dhe jetojnë në rrugë;
- Fëmijët nga pakicat e ndryshme dhe
- Fëmijët me aftësi të kufizuara.

Save the Children, ka thyer pengesat për të mbështetur të drejtat themelore të fëmijëve më të varfër në Kosovë, duke sjellë gëzim për mijëra fëmijë duke luftuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre pa dallim, race, gjinie, etnie, religjioni apo dallime tjera.

⁷² Ibidem

Kapitulli III

3.1 Analiza statistikore të institucioneve relevante mbi të drejtat e fëmijëve në Kosovë

Gjatë hulumtimit të gjetjeve të analizave statistikore të institucioneve relevante mbi të drejtat e fëmijëve në Kosovë, në këtë kapitull të punimit jemi ndalur tek analizimi i projektit me titull “Parandalimi i Dhunës në Shkolla dhe Delikuencës së të Miturve”, projekt ky i realizuar nga Policia e Kosovës. Në vazhdim, do të trajtojmë detajisht hulumtimet dhe gjetjet që përmban projekti në fjalë.

Sikurse e cekëm më lartë, Policia e Kosovës, konkretisht Departamenti për operacione, ka hartuar projektin me emrin: “Parandalimi i dhunës në shkolla dhe delikuencës së të miturve”.

Dhuna në shkolla (*School Bullying, në anglisht*) dhe delikuenca e të miturve në përgjithësi është një realitet i pothuajse i përditshëm për miliona nxënës të shkollave në mbarë botën. Kohën e fundit, jemi dëshmitarë të shfaqjes së disa sjelljeve jo-shoqërore apo të dhunshme të formave të ndryshme në shoqërinë tonë. Së fundmi, një perceptim është shfaqur në shoqëri ku mendohet se sjelljet e dhunshme apo dhuna në cilën do formë është bërë më e përhapur dhe e theksuar në shoqëri, duke përfshirë edhe institucionet e edukimit para-universitar të Republikës së Kosovës.⁷³

Lirisht mund të themi se, një nga arsyet e manifestimit të dhunës në shkolla është mungesa e kulturës për raportimin e kësaj dukurie nga vet viktimat apo përjetuesit e dhunës, dëshmitarët apo personeli shkollor dhe, kur bëhet fjalë për viktimën potenciale ata, dhunën e ushtruar ndaj tyre e konsiderojnë si diçka normale me të cilën ata vetë duhet të ballafaqohen dhe të nënshtrohen.⁷⁴

Në vijim mund të shihni statistikën e incidenteve në dhe përreth shkollave si dhe krahasimin e tyre gjatë vitit 2013 dhe periudhës së njëjtë të vitit 2014 në nivel vendi:⁷⁵

⁷³ Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, *Projekt Parandalimi i dhunës në shkolla dhe delikuencës së të miturve*, 2015, f. 2

⁷⁴ Po aty, f. 3


⁷⁵ Po aty

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Rastet e paraqitura 2013	34	42	40	36	32	29	13	12	44	36	49	20	387
Rastet e paraqitura 2014	79	57	52	41	46	29	8	14	38	53	63	31	511

Tabela 1: Statistika të rasteve të paraqitura në shkolla dhe krahasimi ndërmjet viteve 2013-2014

Në Tabelën 1 janë prezantuar numerikisht rastet e incidenteve të shënuara në shkolla dhe përreth shkollave duke i krahasuar këto statistika të vitit 2013 me vitin 2014. Sipas këtyre statistikave kemi këto të dhëna: periudha Janar për vitin 2013 përfshinë 34 raste të denoncuar kurse në vitin 2014 për këtë periudhë mujore kemi 79 raste të incidenteve në ambiente shkollore që flet për një rritje të theksuar të rasteve me incidente të shënuara. Muaji Shkurt i vitit 2013 shënon 42 raste të incidenteve kurse po ky muaj i vitit 2014 shënon 57 raste. Edhe në këtë periudhë mujore në krahasim me dy vitet 2013-2014 kemi progres apo rritje të incidenteve të shënuara. Muaji Mars, 2013 përfshinë 40 raste të incidenteve në shkollës kurse për vitin 2014 janë identifikuar gjithsejt 52 raste, përsëri kemi rritje të incidenteve të shënuara. Në periudhën Prill, 2013, kemi gjithsejt 36 raste ndërsa periudha Prill, 2014 shënon 41 raste të incidenteve shkollore. Në muajin Maj 2013 janë 32 raste kurse në muajin Maj, 2014, janë shënuar 46 raste. Muaji Qershor, 2013 dhe Qershor 2014 shënon 29 raste. Këtu numri i rasteve për këtë periudhë kohore për të dyja vitet është i njejt/barabartë. Muaji Korrik, 2013 ka 13 raste me incidente në shkolla kurse muaji Korrik i vitit 2014 shënon ulje në 8 raste për dallim nga viti paraprak. Muaji Gusht i vitit 2013 shënon 12 raste me incidente kurse në vitin 2014 kemi 14 raste me incidente në ambiente shkollore. Në muajin Shtator 2013 janë shënuar 44 raste të dhunës në shkolla ndërsa në vitin 2014, për muajin Shtator kemi 38 raste. Muaji Tetor i vitit 2013 shënon 36 raste ndërsa numri i rasteve të dhunës dhe delikuencës së të miturve rritet konsiderueshëm në vitin 2014 deri në 53 raste për muajin Tetor të këtij viti. Muaji Nëntor, 2013 ka shënuar 49 raste të dhunës në shkolla, kurse 63 raste për muajin Nëntor të vitit 2014. Muaji Dhjetor i vitit 2013 numëron 20 raste të incidenteve kurse muaji Dhjetor i vitit 2014 gjithsejt 31 raste me incidente. Gjithsejt, për vitin 2013 numërohen 387 raste të incidenteve të shënuara, kurse për vitin 2014 janë shënuar plot 511 raste me incidente të dhunës dhe delikuencës së të miturve. Numri i rasteve të shënuara është rritur dukshëm në vitin 2014 në krahasim me rastet e shënuara në vitin 2013.

Në vazhdim do të prezantojmë grafikun e statistikave të rasteve të paraqitura në shkolla dhe do të bëhet krahasimi i tyre ndërmjet viteve 2013 dhe vitit 2014.



Burimi: Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, *Projekt Parandalimi i dhunës në shkolla dhe delikuencës së të miturve*, 2015, f. 3

Bazuar në grafikun e prezantuar, kemi këto të dhëna: për muajin Janar 2013 janë paraqitur 34 raste ndërsa për vitin 2014 gjithsejt 79 raste në muajin Janar. Në muajin Shkurt, 2013 kemi 42 raste të paraqitura kurse në vitin 2014, 57 raste. Për muajin mars 2013 janë paraqitur 40 raste ndërsa 52 raste në vitin 2014. Në muajin Prill të vitit 2013 kemi 36 raste kurse në vitin 2014 janë shënuar 41 raste. Në muajin Maj 2013 kemi 32 raste të paraqitura kurse në vitin 2014 po në këtë muaj janë shënuar gjithsejt 46 raste. Në muajin Qershor të vitit 2013 dhe vitit 2014 janë paraqitur numër i njejtë i rasteve me gjithsejt 29 raste. Në muajin Korrik 2013 kemi 13 raste, kurse Korrik 2014 janë paraqitur 8 raste. Në muajin Gusht 2013, kemi 12 raste kurse në vitin 2014 gjithsejt 14 raste të paraqitura. Muaji Shtator 2013 shënon rritje të rasteve të paraqitura në krahasim me muajt paraprak, gjithsejt 44 raste, kurse viti 2014 gjithsejt 38 raste. Muaji Tetor 2013 shënon 36 raste të paraqitura, ndërsa Tetor 2014 gjithsejt 53 raste. Në muajin Nëntor 2013 janë paraqitur 49 raste, kurse Nëntor 2014 janë 63 raste të paraqitura. Muaji Dhjetor 2013 numëron 20 raste të paraqitura kurse Dhjetor 2014 janë paraqitur 31 raste. Në

këtë grafikon, shohim ndryshime rreth numrit të rasteve të paraqitura në periudhat mujore të vitit 2013 dhe 2014, ku viti 2014 prin në raport me vitin 2013 sa i përket rasteve të paraqitura.

Tabela 2: Rastet e paraqitura në shkolla dhe në afërsi të tyre gjatë vitit 2014

RASTET E PARAQITURA NË SHKOLLA DHE NË AFËRSI TË TYRE GJATË VITIT 2014														
Nr.	Rastet e Paraqitura	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
1	Vrasje	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
2	Lëndim i lehtë trupor	14	14	11	8	6	4	0	0	15	12	14	9	107
3	Lëndim i rëndë trupor	1	1	0	2	0	0	0	0	1	4	1	0	10
4	Prishje e rendit dhe qetësisë publike	5	6	9	7	4	1	0	1	5	4	6	6	54
5	Vjedhje	8	8	8	7	6	8	2	2	6	9	8	2	74
6	Vjedhje e rëndë	6	6	3	1	4	1	1	0	3	5	5	5	40
7	Posedim i substancave narkotike	1	1	3	2	2	2	0	0	0	2	1	1	15
8	Dëmtim prone	2	7	6	3	9	9	5	7	4	3	6	4	65
9	Posedim i armës së zjarrit	0	1	0	0	1	0	0	0	0	2	3	0	7
10	Posedim i armës së ftohtë	25	2	3	4	3	0	0	2	0	1	6	0	46
11	Posedim i sendeve të rrezikshme (tjera)	8	2	2	0	1	0	0	0	0	2	2	1	18
12	Zjarrvënje	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1	0	2
13	Tentim Vetëvrasje	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
14	Grabitje	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	2
15	Kanosje	2	4	3	1	3	2	0	1	1	4	6	2	29
16	Pengim i personit zyrtar	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	2
17	Ngacmim seksual	1	0	0	1	1	0	0	0	0	1	1	0	5
18	Tjera	4	5	3	4	4	1	0	1	2	4	3	1	32
	Gjithësej	79	57	52	41	46	29	8	14	38	63	63	31	511


Burimi: Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, *Projekt Parandalimi i dhunës në shkolla dhe delikuencës së të miturve*, 2015, f. 4

Tabela nr. 2 pasqyron rastet e paraqitura në shkolla dhe në afërsi të tyre gjatë vitit 2014. Rastet e paraqitura janë këto: *Vrasje*: në muajin janar gjithsejt 2 raste të paraqitura. Rasti tjetër i paraqitur është *lëndimi i lehtë trupor*. Në muajin Janar kemi 14 raste po aq sa edhe në muajin Shkurt, në Mars, 11 raste, Prill 8 raste, Maj 6 raste, Qershor 4 raste, Shtator 15 raste, Tetor 14 raste, Nëntor 14 raste si dhe në muajin Dhjetor kemi 9 raste, gjithsejt gjatë vitit 2014 janë paraqitur 107 raste të lëndimit të lehtë trupor. Rast tjetër i shënuar është edhe *lëndimi i rëndë*

trupor. Në muajt Janar-Shkurt janë paraqitur nga 1 rast, në muajin Prill kemi 2 raste, në muajin Shtator 1 rast, në muajin Tetor 4 raste si dhe 1 rast në muajin Nëntor, pra, gjithsejt 10 raste të lëndimit të rëndë trupor. Rast tjetër është edhe *prishja e rendit dhe qetësisë publike*. Në muajin Janar janë numëruar 5 raste, Shkurt, 6 raste, në muajin Mars, 9 raste të paraqitura, në muajin Prill, 7 raste, në muajin Maj, 4 raste, Qershor dhe Gusht nga 1 rast i paraqitur, në muajin Shtator gjithsejt 5 raste të paraqitura, në muajin Tetor, 4 raste, ndërsa në muajt Nëntor – Dhjetor nga 6 raste secili muaj. Gjithsejt janë shënuar 54 raste të *prishjes së rendit dhe qetësisë publike* gjatë vitit 2014. Tjetër rast është edhe *vjedhja*. Sipas statistikave të shënuara, në muajt Janar-Shkurt-Mars janë shënuar nga 8 raste të vjedhjes, në muajin Prill, 7 raste, në muajin Maj, 6 raste, në muajin Qershor 8 raste të vjedhjes, Korrik-Gusht nga 2 raste, në muajin Shtator kemi 6 raste, në muajin Tetor kemi 9 raste, Nëntor paraqiten 8 raste dhe në muajin Dhjetor kemi 2 raste. Gjithsejt janë 74 raste të vjedhjes. Rast tjetër i shënuar është edhe *vjedhja e rëndë*. Sipas muajve kemi këto raste të evidentuara: Janar-Shkurt nga 2 raste, Mars, 3 raste, Prill, 1 rast, Maj, 4 raste, Qershor-Korrik kemi nga 1 rast, Shtator kemi 3 raste, Tetor-Nëntor-Dhjetor nga 5 raste. Gjithsejt 40 raste të vjedhjes së rëndë. Rast tjetër i paraqitur është edhe *posedimi i substancave narkotike* për periudhat si në vijim: Janar-Shkurt me nga 1 rast, Mars, 3 raste, Prill-Maj-Qershor me nga 2 raste për këto muaj, Tetor 2 raste si dhe Nëntor-Dhjetor nga 1 rast të shënuar. Në total, 15 raste. Tjetër rast i shënuar është edhe *dëmtimi i pronës*. Statistikat për këtë rast janë si në vijim: Janar, 2 raste, Shkurt, 7 raste, Mars, 6 raste, në Prill kemi 3 raste, Maj-Qershor me nga 9 raste të shënuara, në muajin Korrik janë paraqitur 7 raste, në muajin Gusht, 7 raste, Shtator, 4 raste, Tetor, 3 raste, Nëntor, 6 raste si dhe në muajin Dhjetor 2014, 4 raste. Gjithsejt, 65 raste të dëmtimit të pronës. Tjetër rast i paraqitur është edhe *posedimi i armës së zjarrit*. Lidhur me këtë rast, kemi këto statistika: 1 rast i paraqitur në muajin Shkurt, 1 rast në muajin Maj, 2 raste në muajin Tetor, 3 raste në muajin Nëntor. Plotë, 7 raste të shënuara. Rast tjetër është edhe *posedimi i armës së ftohtë*. Statistikat lidhur me rastin në fjalë janë sikurse në vijim: në muajin Janar kemi 25 raste të shënuara, 2 raste në Shkurt, 3 raste në muajin Mars, 4 raste në Prill, 3 raste në muajin Maj, 2 raste në muajin Gusht, 1 rast në muajin Tetor si dhe 6 raste në muajin Nëntor. Gjithsejt, 46 raste. Rasti *posedimi i sendeve të rrezikshme (tjera)* shënon këto statistika: 8 raste në muajin Janar, Shkurt-Mars me nga 2 raste, 1 rast në muajin Maj, 2 raste në muajt Tetor-Nëntor si dhe 1 rast në muajin Dhjetor. Gjithsejt 18 raste. Rast tjetër i shënuar është edhe *zjarrëvënja*. Sipas të dhënave të hulumtimit, janë shënuar gjithsejt 2 raste, njëra në muajin Prill dhe rasti tjetër në muajin Nëntor. Rast tjetër është edhe *tentim vetvrasja*. Është

shënuar vetëm 1 rast dhe ai në muajin Maj. Rasti tjetër i shënuar është *grabitja*. Janë shënuar 2 raste të grabitjes, njëra në muajin Mars si dhe rasti tjetër në muajin Shtator. Tjetër rast i evidentuar është *kanosja*. Për këtë vepër kemi këto statistika sipas muajve: 2 raste në Janar, 4 raste në muajin Shkurt, 3 raste në muajin Maj, 1 rast në muajin Prill, 3 raste në muajin Maj, Qershor i kemi 2 raste, Gusht-Shtator me nga 1 rast, 4 raste në muajin Tetor, 6 raste në muajin Nëntor si dhe 2 raste në muajin Dhjetor. Gjithsejt, 29 raste të paraqitura. Një tjetër rast është *pengimi i personit zyrtar*. Ky rast është evidentuar në muajt Maj-Qershor me nga 1 rast. Gjithsejt, 2 raste. Rast tjetër është *ngacmimi seksual*. Sipas statistikave kemi këto të dhëna: 1 rast në muajin Janar, Prill-Maj nga 1 rast, Tetor-Nëntor poashtu nga 1 rast. Në total, 5 raste të ngacmimeve seksuale. Si dhe raste *tjera* të paraqitura përfshijnë këto statistika: 4 raste në Janar, 5 raste në muajin Shkurt, 3 raste në muajin Mars, Prill-Maj me nga 4 raste, Qershor-Gusht nga 1 rast, 2 raste në muajin Shtator, 4 raste në Tetor, 3 raste në muajin Nëntor si dhe 1 rast në muajin Dhjetor. Gjithsejt, 32 raste të numëruara. Numri i përgjithshëm i të gjitha rasteve të paraqitura për vitin 2014 është sikurse në vijim: gjithsejt, 79 raste të paraqitura në Janar për të gjitha llojet e rasteve të sipërpërmendura, 57 raste në Shkurt, 52 raste në muajin Mars, 41 raste në muajin Prill, 46 raste në muajin Maj, 29 raste në muajin Qershor, 8 raste në Korrik, 14 raste në muajin Gusht, 38 raste në muajin Shtator, 53 raste në muajin Tetor, 63 raste në muajin Nëntor si dhe 31 raste në muajin Dhjetor 2014. Gjithsejt, të evidentuara 511 raste për të gjitha llojet e rasteve të lartëcekura.

Grafikoni 2: Grafika e rasteve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2013-2014



Burimi: Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, *Projekt Parandalimi i dhunës në shkollë dhe delikuencës së të miturve*, 2015, f. 4

Në grafikonin dy, janë shënuar rastet e paraqitura në shkolla dhe në afërsi të tyre gjatë vitit 2013-2014. Sipas këtyre të dhënave, për vitin 2014 kemi 2 raste të vrasjes, *lëndim i rëndë trupor*, 86 raste në vitin 2013 kurse 107 raste në vitin 2014, për veprën *lëndim i lehtë trupor* në vitin 2013 kemi 8 raste kurse në vitin 2014, gjithsejt 10 raste. Vepra tjetër *prishja e rendit dhe e qetësisë publike*, shënon 50 raste në vitin 2013 si dhe 54 raste për vitin 2014, rastet e *vjedhjes* në vitin 2013 janë 78 kurse në vitin 2014 janë evidentuar 74 raste të vjedhjes. Për *vjedhje të rëndë*, në vitin 2013 janë shënuar gjithsejt 31 raste kurse në vitin 2014 janë 40 raste të tilla. Vepra, *posedimi i substancave narkotike*, shënon 6 raste për vitin 2014 si dhe 15 raste në vitin 2014, rasti i *dëmtimit të pronës*, numëron 56 raste për vitin 2013 si dhe 65 raste për vitin 2014. Vepra, *posedim i armës së zjarrit*, në vitin 2013 shënon 8 raste kurse në vitin 2014 shënon 7 raste, *posedim i armës së ftohtë*, për vitin 2013 janë evidentuar 13 raste, kurse për vitin 2014 gjithsejt 46 raste. Rasti i *posedimit të sendeve të rrezikshme (tjera)*, për vitin 2013 përfshinë 8 raste kurse për vitin 2014 gjithsejt 18 raste të tilla. *Zjarrëvënia*, për vitin 2013 përfshinë 2 raste po aq sa edhe në vitin 2014. Rastet e *tentim vrasjes*, për vitin 2013 evidenton 3 raste kurse për vitin 2014 gjithsejt 1 rast. Rasti i *grabitjes*, shënon 1 rast në vitin 2013 si dhe 2 raste në vitin 2014. Rastet e *kanosjes*, përfshinë 11 raste për vitin 2013 si dhe 29 raste për vitin 2014, vepra, *pengim i personit zyrtar*, për vitin 2013 shënon 3 raste kurse në vitin 2014 gjithsejt 2 raste. Vepra e *ngacmimit seksual*, për vitin 2013 shënon 3 raste, kurse në vitin 2014 shënon 5 raste si dhe raste të tjera të evidentuara për vitin 2013 janë 22 kurse për vitin 2014 janë 32 raste.

Në vendin tonë, akoma mbetet shqetësues fakti i shkeljes së të drejtave të fëmijëve pothuajse në secilën sferë. Përpjekjet janë të mëdha në përmirësimin e gjendjes, por nuk mund të themi se kemi shënuar progres të madh në këtë drejtim. Mbetet ende shumë punë për tu bërë.

3.2 Të drejtat e fëmijëve të prekur nga sindromi Down në Kosovë

Sindroma Down është kusht gjenetik. Trupi i njeriut është i përbërë nga qelizat. Çdo qelizë në trupin e njeriut ka 46 kromozome, 23 kromozome të trashëguar nga njëri prind dhe 23 të tjera të trashëguar nga tjetri prind. Në rastin e sindromës Down, në çiftin e

21-të bashkangjitet një kromozom shtesë si pasojë e një ndarjeje anormale qelizore, dhe si rezultat individi ka 47 kromozome në çdo qelizë ose në një pjesë të qelizave të trupit të tij. Termi sindromë nënkupton një varg karakteristikash të cilat shfaqen së bashku. Për herë të parë sindroma Down është përshkruar në një punim akademik të dr. Longdon Down, në vitin 1886, për nder të të cilit është emërtuar me po këtë emër. Sindroma Down nuk është sëmundje, ndaj dhe nuk ofrohet kurë mjekësore për të.⁷⁶

Në bazë të gjeturave të hulumtimit “E drejta në gjithëpërfshirje e fëmijëve me sindromë Down” janë nxjerrë një numër i rekomandimeve për eliminimin e barrierave dhe përmbushjen e nevojave gjatë procesit të gjithëpërfshirjes së nxënësve me sindromën Down në shkolla të arsimit të rregullt. Rekomandimet e dhëna janë të përshkruara mëposht:⁷⁷

- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë duhet të plotësojë kushtet e nevojshme për zbatimin e strategjisë të arsimit gjithëpërfshirës në të gjitha shkollat. Ata duhet të ndajnë një buxhet më të madh për DKA-të, në mënyrë që kërkesat e nevojshme të shkollave në kuadër të procesit të gjithëpërfshirjes të mund të plotësohen.
- Institucionet përkatëse duhet të ofrojnë trajnime adekuate për të gjithë mësime dhënësit në shkollat e rregullta, përfshirë këtu edhe mësime dhënësit e ciklit të lartë (klasa 6-9), në mënyrë që të gjithë mësime dhënësit të jenë të aftë dhe të përgatitur profesionalisht për të punuar me nxënës me sindromën Down.
- Qendrat Burimore, në bashkëpunim me Komisionet Vlerësuese duhet të kenë një bashkëpunim më të ngushtë me të gjitha shkollat e rregullta, në mënyrë që të sigurohen që të gjithë nxënësit me sindromën Down do të kalojnë në procesin vlerësues për nevoja të veçanta arsimore, si dhe të kenë të hartuar planin individual arsimor (PIA).
- Pjesëmarrja e mësime dhënësvë dhe prindërve të nxënësve me sindromën Down duhet të jetë obliguese në hartimin e PIA-së.

⁷⁶ Down Syndrome Kosova, *Çfarë është sindroma Down ?*, <http://www.downsyndromekosova.org/cfare-eshte-sindroma>, 2014, (qasur më: 12.08.2018)

⁷⁷ Down Syndrome Kosova, *E drejta në gjithëpërfshirje e fëmijëve me sindromë Down – Rekomandime*, <http://www.downsyndromekosova.org/1774.html>, 2018, (qasur më: 12.08.2018)

- Implementimi dhe rishikimi i PIA-së duhet të bëhet në mënyrë sistematike nga ekspertët e fushës, në mënyrë që ky plan të jetë gjithmonë në hap me zhvillimin e nxënësit me sindromën Down dhe t'i përshtatet sa më mirë atij. Në rishikimin e PIA-së duhet që gjithmonë të marrin pjesë të gjithë mësimehmënesit e nxënësit me sindromën Down (nëse është në klasën 6-9).
- MASHT, në bashkëpunim me DKA-të duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha në sigurimin e mësimehmënesve mbështetës të specializuar për punë me nxënësit me sindromën Down. Ata duhet të sigurohen që të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të kenë mësimehmënes mbështetës në shkollë.
- MASHT, në bashkëpunim me DKA-të duhet të bëjnë sigurimin e mjeteve të nevojshme konkretizimit (figura, objekte të ndryshme, libra me fotografi, etj.) për shkollat të cilat punojnë më nxënësit me sindromën Down.
- Numri i nxënësve në klasat e shkollave të qytetit të Prishtinës duhet të reduktohet dukshëm, në mënyrë që mësimehmënesit të jenë në gjendje t'i kushtojnë kohën dhe përkushtimin e duhur të gjithë nxënësve në klasë.
- MASHT, në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat tjera relevante që i përkasin fushës së edukimit duhet të organizojnë fushata vetëdijësuese për të gjitha palët e përfshira në procesin e gjithëpërfshirjes, e në veçanti për shkollat dhe prindërit. Këto fushata do të duhej të fokusoheshin jo vetëm në reduktimin e stigmës dhe diskriminimit kundrejt fëmijëve me aftësi të kufizuara (përfshirë edhe ata me sindromën Down), por edhe në informimin e përgjegjësive dhe të drejtave që palët e përfshira në procesin e gjithëpërfshirjes kanë. Këtu rëndësi të madhe do të duhej t'i kushtohet vetëdijësimit të prindërve të nxënësve me sindromën Down, mbi të drejtën e fëmijëve të tyre për vijimin e mësimin në shkollë të rregullta, si dhe nevojave të veçanta që fëmijët e tyre kanë.
- MASHT duhet të sigurojë prezencën e psikologëve në të gjitha shkollat e rregullta, sidomos në ato të viseve rurale të komunës së Prizrenit.⁷⁸

⁷⁸ Down Syndrome Kosova, *E drejta në gjithëpërfshirje e fëmijëve me sindromë Down – Rekomandime*, <http://www.downsyndromekosova.org/1774.html>, 2018, (qasur më: 12.08.2018)

Kosova është një ndër shtetet në rajon që investon më së paku në edukimin dhe mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve. Për Kosovën mbetet shqetësues fakti i shkeljes së të drejtave të fëmijëve pothuaj në shumë segmente. Fëmijët e prekur nga sindromi Down, gëzojnë të gjitha të drejtat sipas legjislacionit aktual të Republikës së Kosovës sikurse fëmijët e tjerë.

Duhet të bëhet aktivizimi i këtyre fëmijëve si dhe socializimi i tyre në mënyrë që lehtësisht të integrohen dhe pranohen dhe mos paragjykohen në shoqëri.

3.3 Iniciativat e OJQ-ve të tjera mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë

Në kapitujt paraprak u potencuan disa nga OJQ-të me spektër më të madh në rolin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, por kjo nuk përjashton edhe OJQ-të e tjera që merren me këtë çështje.

Megjithëse, është e qartë se fëmijët janë të gjithëpranishëm në shoqërinë njerëzore, si në hapësirë ashtu edhe në kohë, është e vërtetë të thuhet se fëmijëria është një fenomen relativisht i fundit në shkencat shoqërore.⁷⁹

Duke pasur parasysh nevojën e madhe për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe mungesën e një ligji specifik në Kosovë tash e sa kohë, shumë OJQ në Kosovë marrin iniciativa për të promovuar barazinë ligjore dhe vënë në pah shkeljet që ju bëhen fëmijëve në Republikën e Kosovës.

⁷⁹ Chris Jenks, *Childhood*. Ssecond Edition. (London and New York: Routledge, 2005), p. 52

Kapitulli IV

4.1 Avokati i Popullit si mbrojtës i të Drejtave të Fëmijëve

Avokati i Popullit, në disa shtete i njohur edhe si Ombudspersoni, mbron dhe promovon të drejtat e fëmijëve. Çdo fëmijë ka të drejtat e tij themelore, të tilla si: e drejta për përkujdesje, e drejta për arsim dhe edukim, e drejta në mbrojtje sociale, e drejta e argëtimit, e drejtësisë (...). Të gjitha këto të drejta, e shumë të drejta të tjera, janë të përcaktuara në ligje, e në mënyrë të posaçme theksohen në Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës.

Fjala Ombudsman është term me prejardhje skandinave në kuptimin e atij që shqyrton ankesat e popullit dhe që në Evropë është funksionar publik që heton ankesat e qytetarëve për keqadministrimin në fusha të veçanta të administratës publike dhe ka juridiksion të kufizuar duke bërë kështu që shumë ankesa të mbeten pa u hetuar.⁸⁰

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton në Kapitullin e XII të saj, rolin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit në Kosovë, si dhe më tej, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), përgjegjësitë dhe mënyrën e punës së IAP-së, si dhe rregullon procedurat për parashtrimin e ankesave dhe hetimin e tyre.

Ky ligj ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.⁸¹

⁸⁰ Skender Gojani, *Fjalor i Terminologjisë Juridike*, (Prishtinë: Kolegji Biznesi, 2013), f. 181

⁸¹ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, 2015, Neni 1.1

Fëmijët duhet të bëhen objekt i një respekti të veçantë dhe të mbrohen kundër çdo forme atentati trupor.⁸²

Nëse vëreni apo ndesheni se të drejtat e një fëmije nuk respektohen, apo shkelen të drejtat e fëmijëve, mund t'i drejtoheni Avokatit të Popullit.

Është e mundur që fëmijët të mos kenë kapacitetet e nevojshme për të ushtruar të drejta të ndryshme lirie në emër të tyre. Kjo nuk nënkupton që fëmijët janë të privuar nga të drejtat në vetvete, por që të rriturit përgjegjës i ndihmojnë fëmijët në vendosjen e interesave përkatëse si të drejta mbrojtjeje.⁸³

Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi të cilat ligje, bashkë me Ligjin për Avokatin e Popullit përbëjnë pakon ligjore të të drejtave të njeriut, e cila ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015.⁸⁴

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga organet, institucionet ose nga autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës. Si institucion i pavarur, udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

Me qëllim të identifikimit të problemeve dhe me qëllim të sigurimit të të dhënave për shkeljet e supozuara, Kushtetuta dhe Ligji për Avokatin e Popullit detyron çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, t'i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqes atij të gjitha dokumentet dhe të dhënat e kërkuara. Avokati i Popullit zhvillon hetime, jep rekomandime, publikon raporte, si dhe avokon për të drejtat dhe liritë e njeriut. Në rastet kur hetimet e këshilltarëve ligjorë të IAP-së rezultojnë me gjetje të shkeljeve të të drejtave të njeriut, institucioni mund të kërkojë njoftime plotësuese nga autoritetet publike dhe të bëjë rekomandime për autoritetet përgjegjëse përkatëse. Në rastet kur Avokati i Popullit konsideron se një praktikë ose situatë e përgjithshme nuk është në pajtim me standardet vendore a ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndikon te një individ apo më gjerë, bën raporte speciale, të cilat

⁸² ICRC, *Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949 dhe Protokollet Shtesë*. (Prishtinë: ICRC, 2007), f. 268

⁸³ Don Cipriani, *Children's Rights and the Minimum Age of Criminal Responsibility*. (England, USA: Ashgate, 2009) p. 21

⁸⁴ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, 2015, Neni 1.2

përfshijnë edhe rekomandime të drejtuara Kuvendit të Kosovës, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së krijuar dhe të harmonizimit të saj me standardet vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁸⁵

Avokimin dhe ndikimin për avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, Avokati i Popullit mund ta bëjë edhe nëpërmjet mediave. IAP ka mundësi të hapë hetime Ex Officio (pa ankesë individuale/sipas detyrës zyrtare) për dyshimet e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Po ashtu, ka për mision t'i vëzhgojë politikat dhe ligjet e miratuara nga autoritetet vendore, për të siguruar që ato të jenë në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut dhe me kërkesat e qeverisjes së mirë.⁸⁶

Avokati i Popullit është zyrtar jopartiak dhe i pavarur i cili merret me shqyrtimin e ankesave të palëve për shkeljen e të drejtave të njeriut me vendimet jo të drejta institucionale.⁸⁷

Edhe pse IAP merret me hetime lidhur me zvarritjet e procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve, por nuk e zëvendëson gjykatën dhe nuk mund t'i hetojë krimet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo t'i ndryshojë aktvendimet e gjykatës ose të japë vendime detyruese. Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit. Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese. Po ashtu, Avokati i Popullit i ushtron kompetencat e veta edhe me anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit. IAP, nuk merret me hetimin e çështjeve, që kanë të bëjnë me kontestet që zhvillohen ndërmjet personave privat. Shërbimet e ofruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë falas. IAP mund të ofrojë shërbime edhe për ankesa të qytetarëve të saj, që drejtohen kundër autoriteteve publike jashtë Kosovës, dhe t'i përcjellë ato tek institucioni relevant (në shumicën e rasteve tek institucionet homologe - Ombudsman) në vendin tjetër, ose tek ndonjë institucion tjetër homolog.⁸⁸

⁸⁵ Republika e Kosovës, Avokati i Popullit, *Misioni*, <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/misioni>, 2018, (e qasur më: 08.10.2018)

⁸⁶ Po aty

⁸⁷ Hashim Çollaku, Bajram Ukaj, *Fjalor i Shprehjeve Juridike*, (Prishtinë: Republika e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, 2013), f. 18

⁸⁸ Republika e Kosovës, Avokati i Popullit, *Misioni*, <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/misioni>, 2018, (e qasur më: 08.10.2018)

Sfidë dhe objektiv kryesor i IAP-së mbeten krijimi dhe zhvillimi i asaj, që quhet kulturë e qeverisjes së mirë, e cila nënkupton administrim të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të autoriteteve publike para qytetarëve të Kosovës, si dhe forcim të përgjithshëm të sundimit të ligjit. Angazhimi i IAP-së për balancim të raporteve në mes administratës publike dhe qytetarëve, të cilëve kjo administratë mëton t'u shërbejë, ka po këtë qëllim. Rekomandimet e Avokatit të Popullit synojnë të sjellin përmirësime në standardet dhe në cilësinë e shërbimeve të autoriteteve publike ndaj qytetarëve. Synim i veprimtarisë efikase të Avokatit të Popullit është shtimi i besimit të njerëzve te institucioni, edhe tek administrata, duke siguruar relacion koherent ndërmjet qytetarit dhe administratës publike. Kjo është e domosdoshme për funksionimin e demokracisë. Për këtë arsye Avokati i Popullit është pjesë e atyre institucioneve që konsiderohen si garant të demokracisë, të shtetit ligjor dhe të të drejtave të njeriut.⁸⁹

Ankesat e personave juridik dhe fizik mund të drejtohen në IAP, sipas një procedure të thjeshtë dhe pa pagesë. Pranimi i ankesave bëhet në Zyrën Qendrore dhe zyrat rajonale të IAP-së. Këto ankesa mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të autoriteteve publike, që nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e juristëve përkatës kanë të bëjnë me dhënien e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave dhe informatave nga autoritetet publike përkatëse, nga gjykatat dhe nga institucionet e tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara gjyqësore. Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme, IAP paraqet kërkesë për masë të përkohshme. Lidhur me këtë, mënyra e veprimit ndryshon, varësisht nga natyra e rasteve individuale.⁹⁰

Nga të lartëcekurat, mund të përmbledhim se roli i Avokatit të Popullit është mbrojtja e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të çdo personi nga veprimet e paligjshme ose të parregullta të administratës publike. IAP mund ti drejtohet çdo individ ose grup individësh përfshirë këtu edhe fëmijët e mitur.

Avokati i Popullit nuk ofron ndihmë gjyqësore dhe nuk ka kompetencë të ndërhyjë në një proces gjyqësor.

⁸⁹ Republika e Kosovës, Avokati i Popullit, *Misioni*, <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/misioni>, 2018, (e qasur më: 08.10.2018)

⁹⁰ Po aty

Institucioni i Avokatit të Popullit, për herë të parë është aplikuar në Suedi, ndërsa sot ekziston në shumë vende të botës, që kontribuon për kufizimin dhe kontrollin më efikas mbi administratën shtetërore në interes të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ombudsmanët, në të drejtën e krahasuar udhetojnë kontroll mbi veprimtaritë e organeve administrative, ndërsa në disa shtete siç janë Franca dhe Suedia, mund të udhetojnë kontroll edhe mbi veprimtarinë e gjykatave. Avokati i Popullit në Republikën e Maqedonisë është kompetent që ti mbrojë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur atyre u cënohen nga ana e organeve të administratës shtetërore dhe nga organe e organizata tjera që kanë autorizime publike (psh. aeroporti, elektrodistribucioni, etj.). Veçanërisht i kushton kujdes të veçantë ofrimit të mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të anëtarëve të komuniteteve në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të vetadministrimit lokal dhe në shërbimet dhe institucionet publike.⁹¹

Edhe KDF shpall qartë ndalesën e diskriminimit të fëmijëve, duke ofruar një listë të gjatë me bazat që nuk pranojnë dallime (po ashtu lidhur me prindin/rojnë e fëmijës) si “raca, ngjyra, seksi, gjuha, religjioni, mendimi politik, nacional, origjina sociale apo etnike, prona, paaftësia, lindja apo pozita tjetër” (Neni 2).⁹²

Pushteti i Avokatit të popullit është më tepër moral dhe ai ndikon me forcën e autoritetit të tij e jo me mjete të detyrueshme.


4.2 Shkeljet e të drejtave të fëmijëve në Kosovë

Në hulumtimin e realizuar, u njohëm me mjaft shume instrumente ndërkombëtare dhe vendore të cilat mbrojnë dhe garantojnë të drejtat e fëmijëve. Por, mbetet shqetësuese realiteti në Kosovë, ku kemi raste të shumta të mosrespektimit dhe shkeljes së të drejtave të fëmijëve.

⁹¹ Skender Gojani, *Fjalor i Terminologjisë Juridike*, (Prishtinë: Kolegji Biznesi, 2013), f. 36

⁹² Të drejtat e fëmijës, http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/albanian/child/child.htm, (qasur më: 17.09.2018)

Respektimi i të drejtave të fëmijëve në Kosovë, nga përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe Institucioni i Avokatit të Popullit konsiderohen të jenë në nivelin e dëshiruar, ndonëse, thuhet se janë shënuar përparime në disa aspekte gjatë viteve të fundit. Koalicioni i Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) thonë se janë të dhënat e fundit zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të cilat tregojnë për një gjendje jo të kënaqshme të të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Sipas këtyre të dhënave mbi 60 për qind e fëmijëve në Kosovë deri në moshën 14 vjeç kanë pësuar dhunë psikologjike dhe fizike, mbi 10 për qind e fëmijëve në Kosovë janë të përfshirë në punë të rënda, derisa afër 7 për qind punojnë në kushte të rrezikshme.⁹³




Një hulumtim i bërë kohë më parë në Kosovë nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë, UNICEF, thuhet se pabarazitë tek fëmijët janë shfaqur në disa dimensionet, por që veçohen shëndetësia, arsimi dhe siguria. Ndërkohë në Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, thonë se ankesat që më së shumti i kanë pranuar lidhur me shkeljen e të drejtave të fëmijëve kanë të bëjnë me të drejtën në shëndetësi, mirëqenie sociale, kujdes prindëror, dhunë në shtëpi dhe shkollë. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve ishte cilësuar si sfida për Kosovën edhe në Raportin e fundit të Progresit të Komisionit Evropian. Raporti

⁹³ Luljeta Krasniqi-Veseli, *Fëmijëve në Kosovë iu shkelen të drejtat*, <https://www.evropaelire.org/a/dita-e-femijeve-kosove/28522784.html>, 2017, (qasur më: 06.09.2018)

pati theksuar nevojën që autoritetet e Kosovës të sigurojnë një buxhet adekuat për Projektligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve në mënyrë që të këtë zbatim efektiv pas miratimit.⁹⁴

Në Kosovë llogaritet se 33% e fëmijëve jetojnë në varfëri. Sipas të dhënave zyrtare, thuhet se 10.7 % e fëmijëve punojnë në kushte të rrezikshme. Kurse, 61.4% e fëmijëve deri në moshën 14 vjeç kanë pësuar nga dhuna psikologjike dhe fizike.⁹⁵



Ndër tjerash, ndërmjet fëmijëve në Kosovë ka edhe raste ku është e shprehur pabarazia dhe diskriminimi i tyre. Shqetësim tjetër vazhdon të mbetet edhe mos hartimi i Ligjit për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë, e cila në mënyrë shprehimore do t'i rregullonte të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve si dhe do t'i ndëshkonte shkelësit e këtyre të drejtave.

Në shoqërinë e kosovare, fëmijët mbeten kategoria të cilëve më së shumti u cenohen të drejtat. Madje tek fëmijët po ushtrohet edhe dhunë fizike. E janë shkollat ato hapësira ku më së shumti po ushtrohet dhunë nga grupe fëmijësh. Janë pikërisht fëmijët, që në Javën për Parandalimin e Dhunës ndaj Fëmijëve, po kërkojnë që zëri i tyre të dëgjohet, të respektohen e t'ju mbrohen të drejtat e tyre, siç e parasheh edhe Kushtetuta e Kosovës dhe konventa ndërkombëtare për të drejtat e tyre.⁹⁶

⁹⁴ Po aty

⁹⁵ Zëri, *Mungesa e ligjit përkatës, shkelje e të drejtave të fëmijëve*, <http://zeri.info/aktuale/88251/mungesa-e-ligjit-perkates-shkelje-e-te-drejtave-te-femijeve/>, (qasur më: 02.08.2018)

⁹⁶ Kohanet, *Të drejtat e fëmijëve në Kosovë shkelen më së shumti*, <https://archive.koha.net/?id=27&l=30079>, (qasur më: 08.08.2018)

Shikuar statistikat e ndryshme të disa organizatave me renome botërore që merren me të drejtat dhe lirit themelore të njeriut e vërejmë se trajtimi dhe mbrojtja e fëmijëve në nivel global është mjaft e vështirësuar dhe e përcjellë me lloj-lloj keqpërdorimesh dhe abuzimesh (shih statistikat e UNICEFI-it, ku çdo vit, 200,000 fëmijë anembanë botës bëhen viktima të trafikimit me qenie njerëzore, kurse numri i këtyre viktimave, fatkeqësisht, për çdo vit, po bëhet gjithnjë e më i madh. Trafikimi i fëmijëve, i cili konsiderohet si një nga krimet më të rënda, është problem me të cilin ballafaqohen të gjitha vendet e botës. Këta fëmijë janë viktima potenciale të trafikantëve të paskrupullt me qenie njerëzore dhe zakonisht detyrohen të bëhen lypës nëpër rrugë. Sipas vlerësimit të ekspertëve, pas trafikimit me narkotikë dhe me armë, trafikimi i njerëzve është aktiviteti i tretë kriminal me radhë, i cili sjell profite të mëdha. Në disa pjesë të botës, situata është akoma më e keqe. Në Azi, çdo njëmbëdhjetë sekonda, vdes një fëmijë nga uria. Çdo vit, më shumë se 10 milionë fëmijë vdesin kryesisht nga sëmundjet, të cilat mund të parandalohen, siç janë për shembull, pneumonia ose fruthi. Një numër i konsiderueshëm i fëmijëve vdes edhe nga infektimi me HIV, po ashtu dhe nga luftërat). Prandaj, përpos organizimeve për ta shënuar ditën ndërkombëtare të fëmijëve 1 qershorin, duhet pasur parasysh se çfarë po bëjmë për fëmijët tonë, sa po kujdesemi, a po ua njohim të drejtat e tyre të garantuara edhe ndërkombëtarisht dhe sistemi ynë ligjor a i mbron drejtë të drejtat e fëmijëve. Konventa për të Drejtat e Fëmijës ekziston, por fatkeqësisht ajo nuk respektohet gjithkund dhe nuk respektohet ashtu siç duhet. Ne të gjithë duhet të bëjmë çmos që t'i respektojmë të drejtat e çdo fëmije në Kosovë ashtu siç duhet.⁹⁷

Respektimi i të drejtave të fëmijëve në Kosovë nuk është në nivel të kënaqshëm.

Kosova ende duhet të bëjë shumë përpjekje në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjes nga puna e rëndë e fëmijës, duke bërë një koordinim më efektiv mes autoriteteve të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Poashtu, Kosova duhet të sigurojë kujdes më të mirë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

⁹⁷ Burim Haliti, Flamur Hyseni, *Fëmijët dhe kujdesi për respektimin e të drejtave të tyre*, <https://telegrafi.com/femijet-dhe-kujdesi-per-respektimin-e-te-drejtave-te-tyre/>, 2011, (qasur më: 16.08.2018)

Konkluzioni

Padyshim se, të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve do të mbeten thjesht një vizion në letër në qoftë se nuk bëhen kuptimplotë për jetën reale të një personi. Prandaj, ato duhet të kuptohen dhe të lidhen me përvojën konkrete, që do të thotë se, ato duhet të zbatohen në jetën e përditshme dhe shkeljet e tyre duhet të identifikohen. Por, hapi i parë merr kohë.

Me përfundimin e luftës në Kosovë në vitin 1999, në mënyrë të vazhdueshme shënohet një rritje, avancim dhe përmirësim i gjendjes së drejtave dhe të lirive të njeriut në përgjithësi dhe të të drejtave të fëmijëve në veçanti. Ky konstatim bazohet në rezultatet e hulumtimeve të zhvilluara në Kosovë nga shumë organizata qeveritare dhe joqeveritare.

Përmirësimet dhe avancimet në rend të parë janë meritë e bashkësisë ndërkombëtare, e cila nëpërmjet donacioneve të shumta, ndihmave të ndryshme në veshmbathje, në ushqim, në ndërtimin e shtëpive të djegura, organizmit të trajnimeve të shumta me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve në fushën e mësimdhënies; mbrojtjes dhe të promovimit të drejtave dhe të lirive të njeriut, edukimit për të drejtat e njeriut, vetëdijësimin për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit, shfrytëzimit, të dhunës, në fushën e përkrahjes në ndërtimin e institucioneve vendore në parimet e qytetarisë dhe të demokracisë, të shtetit ligjor dhe sundimit të ligjit ka krijuar një realitet tjetër që dallon nga koha e para luftës.

Përkundër përmirësimeve të cekura më lartë, niveli i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Kosovë është treguar i pakënaqshëm.

Fëmijët kosovarë mbesin kategoria të cilës më së shumti u shkelen të drejtat, madje shpeshherë ndaj tyre aplikohet edhe dhuna fizike nga prindërit, mësuesit apo moshatarët e tyre.

Realiteti në Kosovë tregon se fëmijët për shkaqe të rënda ekonomiko- sociale detyrohen t'i braktisin mësimet dhe të punojnë punë të rënda që janë në shpërputhje të madhe me aftësitë e tyre fizike dhe pjekurinë e tyre emocionale.

Nuk janë të rralla rastet, kur fëmijët para kohe shndërrohen në mbajtës të familjes dhe në këtë mënyrë e rrezikojnë shëndetin dhe ardhmërinë e tyre. Ata nuk kanë mbrojtje shëndetësore adekuate dhe kushte për shërim jashtë Kosovës për shkak të kushteve të

vështira ekonomike, kurse rrugët e Kosovës janë të mbushura me fëmijë që kërkojnë lëmshë në vend se t'i vijojnë mësimet.

Në të ardhmen duhet vazhduar me përkushtim dhe vetëdijësim më të madh në ndërmarrjen e masave institucionale për të ofruar mbrojtjen që u takon të gjithë fëmijëve.

Do të ishte mëse e nevojshme për legjistacionin por edhe për një vetëdije të përgjithshme që:

1. Të intensifikohet akoma më shumë vetëdijësimi i qytetarëve, opinionit publik, i zyrtarëve të institucioneve formale, të shoqërisë civile, të komunitetit të prindërve, të komunitetit arsimor, për rolin dhe rëndësinë që kanë mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe humane/miqësore në shoqëri dhe shkolla për mbrojtjen më efektive të të drejtave të fëmijëve.
2. Të krijohet një mekanizëm i qëndrueshëm dhe funksional i adresimit të të gjitha shkeljeve të të drejtave të fëmijëve.
3. Të krijohet një rrjet i fuqishëm që do të monitorojë dhe vlerësojë gjendjen e sigurisë në shoqëri dhe në shkolla.
4. Duhet shtuar numrin e gjykatësve dhe të prokurorëve për të mitur, duhet nxitur dhe stimuluar Shërbimin Sprovues të Kosovës, duke nxitur bashkëpunimin e Qendrave Sociale me Policinë e Kosovës dhe me Institucionet e Arsimit.
5. Kuvendi duhet ta miratojë Ligjin mbi të Drejtat e Fëmijëve.
6. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale duhet të lehtësojë procedurat e birësimit të fëmijëve të braktisur, moszvarritjen e tyre duke marrë parasysh se birësimi është një ndër format themelore të mbrojtjes së fëmijëve të braktisur.

Bibliografia

I – LIBRA

- A. Glenn Mower, Jr., *The Convention on the Rights of the Child*. (Westport, Connecticut, London: Greenwood Press, 1997
- Betty A. Reardon, *Educating for Human Dignity Learning About Rights and Responsibilities*. Philadelphia: Pennsylvania Studies in Human Rights, 1995
- Chris Jenks, *Childhood*. Ssecond Edition. London and New York: Routledge, 2005
- David Archard, *Children Rights and childhood*. Second Edition. (London and New York: Routledge, 2004
- Don Cipriani, *Children's Rights and the Minimum Age of Criminal Responsibility*. England, USA: Ashgate, 2009
- Hashim Çollaku, Bajram Ukaj, *Fjalor i Shprehjeve Juridike*. Prishtinë: Republika e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, 2013
- ICRC, *Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949 dhe Protokollet Shtesë*. Prishtinë: ICRC, 2007
- Katherine Covell and R. Brian Howe, *Children, Families And Violence Challenges For Children's Rights*. London and Philadelphia: Jessica Kingsley Publishers, 2009
- Mary John, *Children's Rights and Power Charging Up for a New Century*. London and New York: Jessica Kingsley Publishers, 2003
- Skender Gojani, *Fjalor i Terminologjisë Juridike*. Prishtinë: Kolegji Biznesi, 2013
- Wolfgang Benedek, *Kuptimi i të Drejtave të Njeriut*. Prishtinë: Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës, 2014

II – ARTIKUJ TJERË

- Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, 1989

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 1948
- Karta Sociale Europiane (e rishikuar), Strasburg, 1966
- Kuvendi i Kosovë, Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, 2010
- Kuvendi i Kosovë, Ligji Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, 2015
- Kuvendi i Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2012
- Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
- Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, 2007
- Ligji Nr.10 425, Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve”, 2011
- Dan O’Donnell, *Korniza Ligjore mbi të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë, Studim mbi pajtueshmërinë e legjislacionit në fuqi me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve*, Unicef: Prishtinë, 2014
- Foundacioni SLYNN, *Zbatimi i të Drejtave të Njeriut në Praktikë*, Londër, UK, 2016
- KIPRED, *Hulumtim me temën Dhuna në Shkolla*, 2013
- Krenare Lleshi dhe Veton Sylhasi, *Fëmijët tanë Udhëzues praktik për prindër dhe mësime dhënë*, Prishtinë: Qendra për Arsimin e Kosovës, 2017
- Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, *Projekt Parandalimi i dhunës në shkolla dhe delikuençës së të miturve*, 2015
- Save the Children, *Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, Për Fëmijët nga Fëmijët*, 2002
- Xhulia Karaj, *Bazat filozofike të të drejtave të njeriut*, Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Europiane, Profili: Legjislacioni dhe Institucionet Europiane, 2015
- Avokati i Popullit, *Historiku*, <http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/historiku-1>, (qasur më: 05.10.2018)
- Awareness day UK, *International Children’s Day 2018*, <https://www.awarenessdays.com/awareness-days-calendar/international-childrens-day-2018/>, (qasur më:08.08.2018)

- Behare Rexhepi, *Çfarë sjell dhuna e përdorur në shkollë ?*, <https://telegrafi.com/cfare-sjell-dhuna-e-perdorur-ne-shkolle/>, 2009, (qasur më: 08.09.2018)
- Burim Haliti, Flamur Hyseni, *Fëmijët dhe kujdesi për respektimin e të drejtave të tyre*, <https://telegrafi.com/femijet-dhe-kujdesi-per-respektimin-e-te-drejtave-te-tyre/>, 2011, (qasur më: 16.08.2018)
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948, <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AUnivers alDeclarationHumanRightsfinal.pdf>, (qasur më: 12.09.2018)
- Down Syndrome Kosova, *Çfarë është sindroma Down ?*, <http://www.downsyndromekosova.org/cfare-eshte-sindroma>, 2014, (qasur më: 12.08.2018)
- Down Syndrome Kosova, *E drejta në gjithëpërfshirje e fëmijëve me sindromë Down – Rekomandime*, <http://www.downsyndromekosova.org/1774.html>, 2018, (qasur më: 12.08.2018)
- Emrush Thai, *Dhuna në shkolla, alarm për institucionet shkollore!*, <https://telegrafi.com/dhuna-ne-shkolla-alarm-per-institucionet-shkollore/>, 2014, (qasur më: 07. 10.2018)
- Ervis Martani, *Origjina dhe Evoluimi i të Drejtave të Njeriut*”, <http://myschool.al/resources/Historia-e-te-drejtave-te-njeriut.pdf>, (qasur më: 05.10.2018)
- Gazeta KNN, *Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve*”, 2017, <http://aab-edu.net/media/gazetaknn/dita-nderkombetare-e-te-drejtave-te-femijeve/>, (qasur më: 02.09.2018)
- Hyrje në sistemin e të drejtave të njeriut, http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/albanian/I_Intro/introduction.pdf, (qasur më: 12.09.2018)
- Kohanet, *Të drejtat e fëmijëve në Kosovë shkelen më së shumti*, <https://archive.koha.net/?id=27&l=30079>, (qasur më: 08.08.2018)

- KOMF Koalicioni i Qeverive për Mbrojtjen e Fëmijëve, <http://www.komfkosova.org/misioni/>, (qasur më: 08.08.2018)
- Living Democracy, *Të drejtat dhe përgjegjësitë*, <http://www.living-democracy.al/textbooks/volume-3/part-2/unit-5/lesson-3/>, (qasur më: 15.09.2018)
- Luljeta Krasniqi-Veseli, *Fëmijëve në Kosovë iu shkelen të drejtat*, <https://www.evropaelire.org/a/dita-e-femijeve-kosove/28522784.html>, 2017, (qasur më: 06.09.2018)
- Marilyn Achiron, *Shtetësia dhe Pashtetësia*, <http://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain/opendocpdf.pdf?reldoc=y&docid=5469fad84>, 2014, (qasur më: 03.09.2018)
- Republika e Kosovës, Avokati i Popullit, *Misioni*, <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/misioni>, 2018, (e qasur më: 08.10.2018)
- Save the Children in Kosovo, <https://kosovo.savethechildren.net/about-us>, (qasur më: 10.08.2018)
- Save the Children in Kosovo, <https://kosovo.savethechildren.net/what-we-do>, (qasur më: 10.08.2018)
- Të drejtat e fëmijës, http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETC-Hauptseite/manual/versionen/albanian/child/child.htm, (e qasur më: 17.08.2018)
- The Robinson Library, *International Year of the Child*, <http://www.robinsonlibrary.com/social/family/family/childyear.htm>, (qasur më: 16.09.2018)
- Unicef Albania, *Dhuna ndaj fëmijëve*, https://www.unicef.org/albania/sq/children_28180.html, (qasur më: 07.10.2018)
- UNICEF Kosovo (under UNCS Resolution 1244), *Programme in Kosovo*, https://www.unicef.org/kosovoprogramme/whoweare_30043.html, (qasur më: 07.09.2018)
- Unicef, *Ndërprerja e dhunës nëpër shkolla*, https://www.unicef.org/tfymacedonia/Priracnik_za_nasilstvo_-_ALB.pdf, (qasur më: 07.10.2018)

- Violence Prevention Alliance, *Definition and Typology of Violence*, <http://www.who.int/violenceprevention/approach/definition/en/>, (qasur më: 07.10.2018)
- Zëri, *Mungesa e ligjit përkatës, shkelje e të drejtave të fëmijëve*, <http://zeri.info/aktuale/88251/mungesa-e-ligjit-perkates-shkelje-e-te-drejtave-te-femijeve/>, (qasur më: 02.08.2018)